



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 8 DHE 9 DHJETOR
2014**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 08. I 09. DECEMBRA 2014. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2014**

Rendi i ditës

1. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Dnevni red

1. Izbor Vlade Republike Kosova

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.

KRYETARI: Mirëmbërëma të gjithëve,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar mysafirë,
Zonja Tracy Ann Jacobson, ambasadore e Shteteve të Bashkuara të Amerikës,
Gjeneralmajor Francesco Paolo Figliuolo, komandant i KFOR-it,
E nderuara zonja Lunaçek, nënkryetare e Parlamentit Evropian,
Ambasadorë dhe përfaqësues të zyrave diplomatike në Kosovës,
Përfaqësues të organizatave ndërkombëtare,
Përfaqësues të bashkësive fetare në Kosovë,
Të nderuara medie që sot po e përcillni këtë zhvillim të mbledhjes së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Me këtë akt i shpall të hapura punimet e mbledhjes plenare.

Konstatohet se në sallë janë të pranishëm 104 deputetë.

Deputetë të nderuar, vazhdojmë me rendin e ditës. E kemi një pikë të rendit të ditës:

1. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Presidentja e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 95 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ia ka propozuar Kuvendit kandidatin për kryeministër të Republikës së Kosovës, zotin Isa Mustafa.

Për ta nominuar kandidaturën e zotit Mustafa, e ftoj kryetarin e partisë fituese në zgjedhjet e fundit nacionale, kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, zotin Hashim Thaçi.

HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar Veseli!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Të nderuar të gjithë ambasadorë, përfaqësues të medieve, qytetarë të Republikës së Kosovës,

Pas procesit të suksesshëm të mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme në Republikën e Kosovës, më 8 qershor 2014, të cilat e nxorën Partinë Demokratike të Kosovës si parti fituese dhe në rrjedhë të ngjarjeve që pasuan pas mbajtjes së këtyre zgjedhjeve, në vazhden e konsultimeve të përbashkëta dhe si rrjedhojë edhe e marrëveshjes së arritur më datën 8 dhjetor 2014 ndërmjet PDK-së dhe LDK-së, ne si Parti Demokratike e Kosovës i kemi propozuar presidentes së Republikës së Kosovës, zonjës Jahjaga, duke marrë parasysh nenin 95, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për mandatar të Qeverisë së Republikës së Kosovës zotërinë Isa Mustafën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Thaçi!

Po procedojmë në bazë të Sekretarisë. E ftoj kandidatin e nominuar për kryeministër të Republikës së Kosovës, zotin Isa Mustafa, para deputetëve...

(Deputeti Visar Ymeri del para foltores dhe e kërkon fjalën.)

Më falni, zoti Ymeri! Të kisha lutur! Unë kam respekt shumë të madh për ju, por më dëgjo, më duhet të procedoj në bazë të ligjit edhe Kushtetutës. Të lutem, e kemi edhe Sekretarinë, e cila është profesionale. Të kisha lutur, se do ta hapim çështjen e debatit menjëherë pas kësaj pike, kur i nominuari zoti Isa Mustafa do ta bëjë ekspozimin e Qeverisë së re. Ju lutem! Po, po! Ju lutem! Edhe një herë, e ftoj kandidatin e nominuar për kryeministër të Republikës së Kosovës, zotin Isa Mustafa, që para deputetëve të

ISA MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Veseli,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar përfaqësues diplomatikë,
E nderuara ambasadore e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zonja Jacobson,
Të nderuar përfaqësues i BE-së,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Më lejoni që para jush dhe para qytetarëve të Kosovës t'i paraqes parimet programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës për katër vjetët e ardhshme.

Në katër vjetët e ardhshme Kosova do të qeveriset nga koalicioni qeverisës i dy partive më të mëdha në vend, së bashku me komunitetet joshumicë.

Ne e kemi përgatitur Programin qeverisës, të cilin do ta aprovojë Qeveria, që sot do ta zgjidhni ju, dhe të njëjtin do t'ia prezantojmë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Koalicioni qeverisës është ndërtuar duke pasur parasysh dhe duke e respektuar vullnetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, të shprehur me votën e lirë, si dhe detyrimin kushtetues për themelimin e institucioneve legjitime të vendit, institucioneve funksionale dhe gjithëpërfshirëse.

Koalicioni zotohet se do të punojë shumë për forcimin e sundimit të rendit dhe të ligjit, për shtetin e të drejtës dhe trajtimin e barabartë të të gjithë qytetarëve të Kosovës përpara ligjit.

Po ashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës është e vetëdijshme për domosdonë që të punojë shumë për zhvillimin ekonomik dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve tanë dhe mbi këtë bazë do të fokusohet në forcimin e sektorit privat, tërheqjen e investimeve të huaja direkte dhe krijimin e sa më shumë vendeve të reja të punës.

Vetëm nëpërmjet forcimit të ekonomisë së tregut, e të bazuar në sundimin e rendit dhe të ligjit, institucionet dhe shoqëria jonë do të arrijnë zhvillim të mirëfilltë ekonomik dhe social.

Qeveria e Republikës së Kosovës përherë merr në konsideratë vizionin dhe vullnetin e qytetarëve të Kosovës për të përqafuar dhe për të mbrojtur vlerat më të mira civilizuese perëndimore, synimin për të përmbushur të gjitha standardet dhe reformat e domosdoshme për anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian, në Kombet e

Bashkuara, në NATO, në OSBE dhe në organizata të tjera ndërkombëtare, si dhe ruajtjen e kultivimin e marrëdhënieve speciale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Më lejoni të theksoj përkushtimin tonë që të zhvillojmë vendin, duke siguruar dhe duke kultivuar bazat e prosperitetit e të kohezionit social.

Qeveria e re do të bashkëpunojë dhe do t'i kultivojë marrëdhëniet me shoqërinë civile, me organizatat e tjera joqeveritare dhe me komunitetin e biznesit.

Qeveria po ashtu zotohet se do të respektojë diversitetin etnik, fetar dhe parimet e një shteti qytetar dhe sekular.

Ne shprehim përkushtimin tonë për fqinjësi të mirë dhe dialog reciprok me shtetet fqinjë të Republikës së Kosovës, me synimin e forcimit të paqes dhe të stabilitetit në rajonin tonë.

Jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e vazhdimit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, zbatimin e marrëveshjeve të arritura në Bruksel dhe angazhimin për arritjen e marrëveshjeve të reja në përputhje me interesin tonë shtetëror.

Ne shprehim përkushtimin për ta ndërtuar një shtet që ofron mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët dhe që lufton pa asnjë kompromis korrupsionin, krimin e organizuar dhe të gjitha llojet e ekstremizmave që mund të dëmtojnë shoqërinë dhe shtetin tonë.

Po ashtu, zotohemi të promovojmë vlerat e lirisë, të tregut të hapur dhe të konkurrencës, si vlera fundamentale të shoqërisë sonë dhe të shtetit tonë të ri.

Synim parësor i Qeverisë së Republikës së Kosovës është që të ndërtojë një qeverisje efektive, kompetente dhe të përgjegjshme, që do të forcojë besimin e qytetarëve të Kosovës dhe të partnerëve tanë ndërkombëtarë për vitalitetin e Kosovës si shtet i ri dhe i pavarur; të forcojë demokracinë qytetare, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të secilit; të promovojë zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien nëpërmjet ekonomisë sociale të tregut; të sigurojë lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe të promovojë shoqërinë e dijes; të ndërmarrë politika që e rrisin cilësinë e jetës, që ofrojnë mundësi të barabarta për qasje në arsim e shëndetësi cilësore, në jetën sociale dhe në shërbimet publike përgjithësisht.

Në bazamentin Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në filozofinë e saj vepruese janë vlerat demokratike evropiane, si: respekti për traditën, liria, drejtësia dhe toleranca, transparenca, liria e të shprehurit, liritë individuale dhe kolektive, që paraqesin fundamentin e shoqërisë moderne evropiane të Kosovës.

Në të gjitha politikat e saj, Qeveria do të promovojë dhe forcojë vizionin për Kosovën shtet i pavarur, demokratik dhe i integruar në strukturat euroatlantike. Qeveria ime do të

angazhohet fuqishëm për funksionim të pavarur të Legjislativit, Ekzekutivit dhe Gjyqësorit, duke krijuar kushte për ngritje të efikasitetit të tyre.

Programi qeverisës i Qeverisë së Republikës së Kosovës përqendrohet në këto shtylla kryesore:

1. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, punësimi dhe mirëqenia;
2. Sundimi i ligjit dhe shteti ligjor;
3. Agjenda evropiane dhe politika e jashtme;
4. Arsimi, shkenca, kultura, sporti dhe zhvillimi rinor; dhe
5. Shëndetësia moderne.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të dashur qytetarë të vendit tim,
Shtyllë e parë e Programit të Qeverisë për katër vjetët e ardhshme do të jetë zhvillimi ekonomik, punësimi dhe mirëqenia.

Zhvillimi ekonomik, promovimi i punësimit dhe rritja e mirëqenies do të bazohen në iniciativën private, konkurrencën dhe tregun e hapur, si forcat kryesore që sigurojnë prosperitet ekonomik.

Roli i Qeverisë do të jetë në ofrimin e kornizës institucionale, brenda së cilës zhvillohen aktivitetet ekonomike, me qëllim të sigurimit të kohezionit të brendshëm të ekonomisë dhe të shoqërisë.

Qeveria do të angazhohet fuqishëm për integrimin e Kosovës në tregjet rajonale dhe globale. Do të përmirësohet mjedisi për gjenerimin e ideve ndërmarrëse, për tërheqjen e investimeve të jashtme dhe për promovimin e punësimit, duke siguruar, në të njëjtën kohë, shfrytëzim racional të resurseve për brezat e tanishëm dhe të së ardhmes. Zhdukja e varfërisë do të jetë objektiv qendror i politikave ekonomike dhe sociale.

Qeveria do të punojë shumë për të gjeneruar rritje të qëndrueshme ekonomike, e cila siguron stabilitet makroekonomik, fiskal dhe social, si dhe reformë strukturale ekonomike, me qëllim që prodhimi vendës, promovimi i eksportit dhe i dijes të mundësojnë gradualisht zvogëlimin e deficitit tregtar.

Orientimet e lartpërmendura do të bazohen në parime fundamentale buxhetore:

(i) qëndrueshmëri buxhetore dhe stabiliteti makrofiskal në fushën e menaxhimit të financave publike;

(ii) koherencë në mes të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, duke ndjekur politikën e ngarkesave të ulëta tatimore në interes të zhvillimit të sektorit privat.

Do të mbështesim sektorin privat dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme në veçanti. Do të aplikohet një sistem i thjeshtë tatimor. Do të rriten kapacitetet e Administratës Tatimore të Kosovës për të kaluar mbledhjen e TVSH-së në brendi të vendit, e jo në kufi. Do të bëjmë përshkallëzimin e TVSH-së. Do të ulët pragu i regjistrimit të bizneseve në TVSH dhe do të përgjysmohet norma e tatimit në qarkullim për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Do të nxiten investimet duke aplikuar pushimet e përkohshme tatimore.

Bujqësia do të ketë prioritet. Do të rritet buxheti për bujqësi, duke e orientuar mbështetjen më shumë drejt prodhimit vendor. Ne do të mbështesim kamatat për kreditë bujqësore, si formë e veçantë e zhvillimit bujqësor. Do të zgjerojmë sistemin e ujitjes për të zvogëluar kostot e prodhimit bujqësor. Do të mbështesim ngritjen e pikave grumbulluese të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Për të përmbushur standardet evropiane, do të investohet në sigurinë e ushqimit. Do të kujdesemi për ruajtjen e tokave bujqësore, lumenjve, pyjeve dhe të ujërave.

Në të ardhmen do të rritet efikasiteti i shpenzimeve publike, duke ju dhënë përparësi shpenzimeve kapitale që të prodhojnë efekte maksimale për ekonominë dhe përfitime të barabarta për të gjithë qytetarët. Do të kujdesemi që deficitin buxhetor të respektojmë rregullën fiskale, ndërkajë do të rriten përfitimet për të gjithë ata që përfitojnë nga fondet publike në përputhje me rritjen ekonomike të vendit dhe me normën e inflacionit. Do të aplikohet plotësisht prokurimi elektronik dhe do të implementohet projekti i e-qeverisjes në të gjitha nivelet dhe sektorët.

Korniza ligjore që prek bizneset do të vlerësohet në baza të rregullta për efektet e saj. Roli i komunave në ofrimin e lehtësirave të të bërit biznes do të rritet, përfshirë dhënien e tokave me qira për investitorë. Regjistrimi i bizneseve do të decentralizohet plotësisht tek autoritetet lokale. Do të heqim çfarëdo monopoli që është krijuar nga sektori publik, përfshirë monopolin e furnizimit me arka fiskale.

Në infrastrukturë, prioritet do të kenë investimet në hekurudha për të funksionalizuar rrjetin hekurudhor dhe për ta integruar atë në rrjetin rajonal dhe ndërkombëtar të hekurudhave. Do të përgatitet projekti për lidhjen hekurudhore me Shqipërinë. Do të punohen në projektimin dhe ndërtimin e stacionit intermodal në mes të Prishtinës dhe Fushë-Kosovës.

Do të rishikohet baza ligjore lidhur me ndërmarrjet publike qendrore dhe lokale. Disa nga ndërmarrjet publike do të menaxhohen nga ministritë përkatëse dhe do të pavarësohen nga buxheti i shtetit duke vendosur një menaxhment profesional. Për secilën ndërmarrje do të vendosen indikatorët kryesorë të performancës.

Sa i përket Agjencisë së Privatizimit dhe ndërmarrjeve shoqërore, do të vendoset afat kohor kur duhet të përmbyllet procesi i privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore. Do të përgatitet një strategji kombëtare, e cila do të aprovohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për përdorimin e fondeve të grumbulluara nga privatizimi dhe likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore. Do të rishikohet baza ligjore për të ngritur efikasitetin e trajtimit të kërkesave të kreditorëve potencialë. Po ashtu, do të ndërmerret

një auditim i rasteve të privatizimeve me spin-off special lidhur me përmbushjen e kushteve të kontratës.

Mobilizimi i të gjitha fondeve që i ka Kosova për të financuar zhvillimin ekonomik, përfshirë fondet nga diaspora, nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore dhe fondet e tjera do të jetë një burim i rëndësishëm i fondit zhvillimor të Kosovës. Do të krijohen incentiva tatimore për mobilizim të kursimeve nga diaspora. Do të fuqizohet roli mbikëqyrës dhe pavarësia e Bankës Qendrore dhe do të punohet intensivisht për të siguruar që Banka Qendrore e Kosovës të bëhet pjesë përbërëse dhe anëtare e barabartë e Bankës Qendrore Evropiane. Ne do të krijojmë parakushtet që normat e interesit në vend të bien në numra njëshifror.

Për të tërhequr investimet e jashtme, ne do të ridizajnojnë paketën fiskale për investitorët e huaj, duke u fokusuar në sektorët ku kapitali dhe ekspertiza vendëse është e pamjaftueshme. Do të fuqizohet e drejta e dhënies së tokës në shfrytëzim nga komunat dhe do të nxiten sidomos investimet nga diaspora shqiptare. Orientimi do të jetë në veçanti tek investimet e jashtme me orientime eksportuese.

Do të krijohet fondi investiv për financimin e bizneseve vendëse dhe bujqësisë me kushte të volitshme kreditore. Mjetet për këtë fond zhvillimor do të sigurohen nga mjetet e grumbulluara nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore.

Do të investohet në ngritjen e infrastrukturës që mundëson zhvillimin e turizmit duke ndërtuar rrugë dhe shtigje deri në lokacione të caktuara. Do të rivalorizohen potencialet turistike të Kosovës bazuar në standardet ndërkombëtare.

Projektet kryesore në infrastrukturë përfshijnë: funksionalizimi i plotë i sistemit hekurudhor, lidhja e hekurudhave me rrjetin rajonal, përfundimi i autostradës Prishtinë-Hani i Elezit, projektimi i autostradës Prishtinë-Gjilan - pika kufitare për Bujanoc, përfundimi i rrugës për Pejë dhe asaj për Mitrovicë, rruga Prishtinë-Podujevë si dhe magjistralla nga Qafa e Duhlës në drejtim të Ferizajt dhe pastaj në drejtim të Gjilanit.

Në fushën e energjisë, do të sigurojmë shfrytëzim optimal të burimeve energjetike që ka Kosova, si një e mirë publike edhe për brezat e ardhshëm, duke përmbushur kriteret mjedisore. Brenda katër vjetësh të qeverisjes, do të sigurohet energji stabile dhe cilësore për amvisëri dhe biznese. Do të ndërtohet Termocentrali “Kosova e Re” dhe do të unifikojmë tregun energjetik me Shqipërinë për të arritur komplementaritet.

Në sektorin e minierave, do të aplikohet qasje strategjike në shfrytëzimin e pasurive minerale. Vendimet për të ardhmen e minierës së Trepçës dhe minierave të tjera të rëndësishme strategjike do të bazohen në strategji të qartë, që reflektojnë interesat ekonomike dhe shtetërore të Kosovës. Në gjashtëmujorin e parë të qeverisjes do të përgatitet strategjia për Trepçën dhe ligji për Trepçën si pasuri nacionale.

Lidhur me furnizimin me ujë, do të përgatiten strategji për ujërat. Do të mundësohet që rreth 90% e popullsisë të kenë qasje në rrjetin me ujë të pijshëm. Në qendrat e mëdha

urbane, që paraqiten si ndotës të mëdhenj të ujërave dhe lumenjve, do të fillojë implementimi i impianteve. Do t'i dyfishojmë sipërfaqet që do të ujiten, ndërsa do të fillojmë investimet madhore duke ndërtuar akumulime.

Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të telekomunikacionit që nga paslufta është penguar shumë si pasojë e problemeve me statusin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Do të punohet më shumë në këtë sektor për të liberalizuar tregun dhe ofruar shërbime cilësore me çmime të ulëta, në përputhje me rrjedhat në tregjet ndërkombëtare, përfshirë sigurimin e kodit telefonik shtetëror. Do të sigurohet një menaxhim më i mirë i PTK - Valës për të rritur vlerën e saj të tregut përpara se të privatizohet.

Qeveria angazhohet për një solidaritet ndërshoqëror, nëpërmjet politikave ekonomike ri-shpërndarëse të të ardhurave.

Qeveria do të angazhohet që asistencë sociale që ofron shteti për të varfrit të sigurojë që familja, me mjetet që merr, të plotësojë nevojat elementare. Do të eliminohen në maksimum pengesat që dekurajojnë kompanitë t'i marrin femrat në punë dhe do të nxitet punësimi i personave të moshuar që ende nuk kanë arritur kohën e pensionimit. Politikat sociale do të sigurojnë stabilitetin financiar dhe qëndrueshmërinë e skemës së kontributeve të obligueshme pensionale, si dhe do të promovojmë skemat e kursimeve vullnetare.

Qeveria beson që duhet ndërtuar një sistem i mirëqenies, i cili objektiv primar e ka riaftësimin e personave që varen nga asistencë sociale.

Do të vazhdojë të rritet ndihma për invalidë, familje të dëshmorëve, veteranëve dhe kategorive të tjera të luftës.

Qeveria do të vazhdojë bashkëpunimin me shoqatat, të cilat përfaqësojnë kategoritë e dala nga lufta, pasi këto kategori përbëjnë një pjesë të ndjeshme të shoqërisë sonë.

Qeveria do të fillojë zbatimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e kategorive të dala nga lufta, i cili Ligj gjithashtu do të amendamentohet në përputhje me kërkesat përkatëse.

Sistemi pensional do të avancojë më tutje për të gjitha kategoritë, pensionet bazike, kontributdhënëse, për personat me aftësi të kufizuara, pensionistët e "Trepçës", ata të ish-pjesëtarëve të TMK-së dhe të FSK-së. Do të vazhdojmë nënshkrimin e marrëveshjeve në sferën e pensioneve me vendet ku kanë punuar shtetasit e Kosovës. Këto marrëveshje do të sigurojnë për realizimin e të drejtës në pension për të gjithë ata që kanë punuar në shtetet tjera. Do të ofrojmë kujdes të veçantë për kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë, si personat me aftësi të kufizuara, fëmijët e braktisur e pensionistët.

Qeveria do të zhvillojë politika aktive sociale që promovojnë ndërmarrësinë, për ta zvogëluar varësinë nga skemat sociale, nëpërmjet ndërmarrësisë tek të rinjtë dhe femrat. Në zonat rurale në veçanti, do të ofrohen mundësi për zhvillim intensiv në bujqësi dhe stimuj të tjerë në fushën e kreditimit bujqësor. Kujdes i veçantë do t'u kushtohet

punëtorëve që ndikohen nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore, në mënyrë që ata të mos bëhen barrë e asistencës sociale.

Është jetike që në shtetin e Kosovës të sundojë ligji. Ky është parim bazë mbi të cilin do të punojë Qeveria e Republikës së Kosovës.

Shteti i Kosovës duhet të forcohet për qytetarët e tij, t'i mbështesë ata në përpjekjet e tyre për të siguruar të ardhura, jetë të qetë dhe të sigurt. Forcimi i ligjit e shtetit ligjor dhe sigurimi i kohezionit të brendshëm socio-ekonomik, do ta ndihmojë shumë konsolidimin e shtetësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Duke besuar se sundimi i ligjit është përcaktues për cilësinë dhe qeverisjen e mirë, Qeveria do të jetë e pakompromis në luftimin e të gjitha formave të kriminalitetit, të korrupsionit, të krimit të organizuar, të terrorizmit dhe të aktiviteteve të lidhura me dukurinë e terrorizmit, krimit ekonomik, trafikimit të qenieve njerëzore, të formave dhe llojeve të tjera të kriminalitetit. Kjo luftë mund të realizohet vetëm me njerëz që kanë duar të pastra dhe që janë të përgjegjshëm.

Qeveria synon që sistemi i drejtësisë dhe i sigurisë në Kosovë të jetë funksional, profesional, i depolitizuar, i integruar dhe i shtrirë në tërë territorin e vendit, në përputhje me standardet evropiane në fushën e ligjit dhe të sigurisë. Sistemi i drejtësisë dhe i sigurisë duhet të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve.

Qeveria e Kosovës e vlerëson si shumë të rëndësishme punën e organeve që merren me sundimin e ligjit, të sigurisë së brendshme e të jashtme dhe angazhohet për fuqizimin e tyre, në përputhje me parimin e ndarjes së pushteteve.

Qeveria do të angazhohet për reformimin dhe fuqizimin e vazhdueshëm të organit të akuzës, si parakusht për luftimin efikas dhe efektiv të kriminalitetit.

Qeveria është e përkushtuar për një prokurori të pavarur dhe të paanshme, me qëllim që, pa kompromis, t'i luftojë të gjitha format e kriminalitetit, duke mbrojtur vlerat më vitale të qytetarit dhe të shoqërisë.

Në sektorin e drejtësisë ekzistojnë sfida të shumta, të cilat do të trajtohen me përkushtim të madh të Qeverisë. Konsiderojmë se me kornizën e re institucionale sistemi i drejtësisë kërkon një stabilitet në mënyrë që të konsolidohet dhe të koncentrohet në përmirësimin e cilësisë, efikasitetit dhe të performansës. Sfidë tjetër është edhe marrja e përgjegjësisë ekzekutive nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit - EULEX.

Qeveria e Kosovës do të angazhohet që të mbështesë institucionet e pavarura gjyqësore në trajtimin e numrit të madh të rasteve të grumbulluara, në përmirësimin, përpunimin e të dhënave dhe të menaxhimit të rasteve.

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes në sistemin e drejtësisë në përgjithësi, Qeveria do të punojë shumë që të zbatojë reformat e nevojshme për zhvillimin e një sistemi gjyqësor

që do të jetë transparent, duke siguruar funksionalizimin e plotë të reformës gjyqësore në pajtim me ligjet e aplikueshme, krijimin dhe përmirësimin e infrastrukturës fizike të gjykatave, me qëllim të plotësimit të nevojave që dalin nga reforma.

Qeveria e Kosovës do të angazhohet për sigurimin e parakushteve dhe administrimin më efikas të sistemit të ekzekutimit të sanksioneve penale. Do të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve të reja infrastrukturore në Shërbimin Korrektues dhe Sprovues të Kosovës dhe rindërtimin e atyre ekzistuese, me ngritjen profesionale të stafit korrektues dhe sprovues dhe ndërmarrjen e masave në risocializimin e të dënuarve, me krijimin e institucioneve të veçanta për ekzekutimin e masave edukuese korrektuese për të mitur në pajtim me Kodin e Drejtësisë për të Miturit. Do të rritet funksionalizimi i Burgut të Sigurisë së Lartë dhe i dy qendrave të reja të paraburgimit, në Prishtinë e Gjilan, dhe aplikimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike për të dënuarit si dhe funksionalizimi i objektit për të mitur me masë edukative.

Mbrojtja dhe respektimi i lirive dhe të drejtave themelore është shtylla kryesore në funksionimin normal të një shteti demokratik. Në fakt, nga kjo varet drejtpërdrejt zhvillimi politik, ekonomik dhe juridik i një shteti. Në Kosovë të drejtat e njeriut dhe liritë garantojnë me ligj. Qeveria do t'i vendosë të drejtat e njeriut lart në agjendën e saj politike; Qeveria do të jetë e përkushtuar në respektimin e të drejtave civile, politike, ekonomike dhe sociale të të gjithë qytetarëve të Kosovës, pavarësisht nga përkatësia e tyre nacionale, etnike, fetare, racore apo gjinore, ashtu siç janë të garantuara me Kushtetutë dhe ligje. Në këtë kuptim, Qeveria e Kosovës do të zbatojë ligjet aktuale, dhe do të vazhdojë të përditësojë strategjitë për të drejtat e njeriut, duke siguruar qasje afatgjatë në këtë drejtim.

Barazia e qytetarëve para ligjit, gjykimi i drejtë, mosdiskriminimi, e drejta pronësore, liria e siguria, dinjiteti i njeriut dhe të drejtat e tjera qytetare janë themelet e rendit kushtetues e ligjor në Kosovë, prandaj Qeveria angazhohet fuqishëm për mbrojtjen e këtyre parimeve dhe të drejtave.

Në mënyrë specifike, Qeveria do të fokusohet në respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grave dhe barazinë gjinore me qëllim të avancimit të pozitës së gruas në shoqëri.

Qeveria e Kosovës do të respektojë dhe zbatojë të drejtat e komuniteteve pakicë në Kosovë, duke treguar përkushtim për integrimin e plotë të tyre në shoqërinë kosovare.

Qeveria do të fokusohet në zbatimin dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve, të drejtave kulturore, të personave me nevoja të veçanta, të drejtat e punës dhe të sindikatave, të drejtat e pronës, të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda në Kosovë, të parandalojë dhe të luftojë trafikimin me qeniet njerëzore, si dhe të ofrojë mbrojtjen dhe ndihmën e nevojshme viktimave të krimeve të dhunës.

Po ashtu, Qeveria do të punojë për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe do të luftojë krimin kibernetik. Në mënyrë specifike, Qeveria do të sigurojë që rekomandimet e Ombudspersonit të adresohen në mënyrë adekuate.

Të nderuar deputetë,

Për një shtet të ri, si Republika e Kosovës, politika e jashtme ka rëndësi jetike, procesi i njohjeve, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare dhe përmirësimi i imazhit ndërkombëtar të vendit tonë janë prioritet i Qeverisë.

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, politika e jashtme e Kosovës do të jetë vazhdimësi dhe reflektim i politikës së brendshme dhe në funksion të ruajtjes së sovranitetit, integritetit territorial, rendit kushtetues, lirive dhe të drejtave të qytetarëve të Kosovës brenda dhe jashtë vendit dhe garantimit të sigurisë së saj shtetërore. Forcimi i shtetit të Kosovës në dimensionin e brendshëm, do të ndikojë pozitivisht edhe në dimensionin e jashtëm. Sigurisht, një dimension i jashtëm i konsoliduar dhe efikas do të reflektohet në një pozitivisht edhe në dimensionin e brendshëm, sidomos në rrafshin e investimeve apo të tjera aspekte.

Njohja ndërkombëtare e pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës do të mbetet prioritet i Qeverisë së Kosovës. Procesi i njohjes së Kosovës ka treguar se shteti i Kosovës është një realitet i pakthyeshëm dhe një faktor i domosdoshëm i paqes dhe i stabilitetit në rajon. Më së miri kjo demonstron nga fakti i njohjes formale të Kosovës nga të gjitha vendet fqinje, me përjashtim të Serbisë, shumica dërrmuese e shteteve nga rajoni dhe komunitetit euroatlantik.

Qeveria e Kosovës do të mbetet fuqimisht e angazhuar për të lobuar për njohje ndërkombëtare nga ana e shteteve anëtare të OKB-së, me qëllim të forcimit të pozicionit ndërkombëtar të Kosovës dhe për të vendosur marrëdhënie diplomatike me shumicën e shteteve anëtare të OKB-së.

Kosova deri më tani ka arritur 108 njohje nga shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe në këtë mënyrë ka arritur qëllimin për të pasur më shumë se 100 vende që njohin Kosovën. Qeveria e Kosovës do të synojë dhe do të punojë që gjatë mandatit të ardhshëm të arrijë njohjen e Kosovës si shtet të pavarur dhe sovran nga 2/3 e shteteve anëtare të OKB-së. Arritja e këtij synimi do të fuqizojë Kosovën si një anëtar i plotë dhe i barabartë i bashkësisë ndërkombëtare dhe do të jetë një kontribut i rëndësishëm për paqen, stabilitetin dhe sigurinë e rajonit. Gjithashtu, kjo do të jetë një shtysë e fuqishme drejt pranimin të saj formal si shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara.

Përkushtimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për të përfunduar njohjen ndërkombëtare do të përqendrohet në një komunikim diplomatik me shtetet që nuk e kanë njohur ende Kosovën, brenda Evropës dhe më gjerë. Kosova do të vazhdojë me përpjekjet saj proaktive për të bindur pesë vendet anëtare të BE-së se njohja e Kosovës është një vendim i drejtë dhe në interes të stabilitetit dhe unitetit evropian.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojë të mbetet e përkushtuar për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërshtetërore me Serbinë dhe vazhdimin e dialogut, që do të synohet të finalizohet më njohjen e ndërsjellë e që do të mundësojë ndërtimin e paqes së qëndrueshme në mes të dyja vendeve dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike e të mira fqinjësore, në frymën evropiane.

Një nga synimet kryesore të qasjes së Kosovës në politikën e jashtme do të jetë forcimi i marrëdhënieve dypalëshe. Me rritjen e numrit të njohjeve, një prioritet vazhdon të mbetet vendosja e marrëdhënieve diplomatike me shtetet që e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran. Marrëdhëniet diplomatike fuqizojnë njohjen e Kosovës dhe forcojnë pozitën si një anëtar i plotë i bashkësisë ndërkombëtare. Gjithashtu, këto marrëdhënie kanë potencial për të sjellë përfitime të tjera të rëndësishme, siç janë investimet e huaja dhe shkëmbimet tregtare.

Përveç vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me vendet kyçe në kontinente të ndryshme, Qeveria e Kosovës synon të zhvillojë marrëdhënie përtej atyre tradicionale diplomatike, sikur që është inicimi i konsultimeve të rregullta politike, nënshkrimi i marrëveshjeve për heqjen e regjimit të vizave, mbrojtja e investimeve si një prioritet për të krijuar një bashkëpunim të mirë dhe bazë ligjore të konsoliduar.

Ne do t'i trajtojmë me prioritet të lartë arsimin dhe shkencën. Mbi këtë bazë, Qeveria e Republikës së Kosovës synon që të ndërtojë një shoqëri të dijes, të integruar në rrjedhat evropiane dhe me mundësi të barabarta për zhvillim personal. Në përputhje me këtë vizion, Qeveria e Republikës së Kosovës angazhohet të ndërtojë një sistem arsimor gjithëpërfshirës, që siguron kushte për formim cilësor dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe të shoqërisë.

Qeveria e Republikës së Kosovës angazhohet që të trajtojë sektorin e arsimit si një prioritet themelor për zhvillimin e vendit, angazhim që do të reflektohet edhe në peshën që do t'i jepet arsimit dhe shkencës në ndarjen e buxhetit vjetor qeveritar.

Programi qeverisës për fushën e arsimit dhe të shkencës synon reformat strukturore në arsim, rritjen e pjesëmarrjes dhe qasjen e barabartë në arsim, sigurimin, garantimin dhe rritjes e cilësisë së arsimit, menaxhimin e institucioneve të arsimit, integrimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, promovimin e shkencës dhe të hulumtimeve të ndryshme shkencore, ndryshimin e skemës së financimit dhe rritjen e financimit të arsimit dhe shkencës.

Po ashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojë të rrisë buxhetin për institucionet publike të kulturës, Teatrin Kombëtar të Kosovës, Qendrën Kinematografike të Kosovës, Filarmoninë e Kosovës, Baletin e Kosovës, Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” e tjera, në mënyrë që të rritet krijimtaria artistike dhe që publikut t'i ofrohen programe të pasura dhe me vlera kulturore. Krahas pasurimit të programit të tyre, buxheti do të orientohet edhe në promovimin e krijimtarisë së tyre në vende të ndryshme të botës. Atyre do t'u garantohet funksionimi profesional, autonom dhe apolitik, si dhe shtrirja e vendimmarrjes.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të rrisë buxhetin për aktivitete tashmë tradicionale që kanë edhe karakter ndërkombëtar, siç janë festivale të ndryshme të filmit dhe të muzikës. Po ashtu, nëpërmjet subvencionimeve të ndryshme do të mbështeten artistët e pavarur për krijime të ndryshme dhe mbështetje për prezantim të tyre në skenën e kulturës ndërkombëtare.

Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i kushtojë një rëndësi të veçantë botimit dhe qarkullimit të librit. Do të rritet buxheti për librin dhe po ashtu do të mbështeten aktivitete të ndryshme botuese që kanë për synim promovimin dhe prezantimin e krijuesve tanë letrarë.

Kinematografia është një fushë e rëndësishme për promovimin e kulturës së vendit tonë, prandaj Qeveria do t'i kushtojë vëmendje të veçantë duke rritur buxhetin për prodhim të filmave dhe për lidhjen e bashkëpunimit me qendra simotra të vendeve të tjera, me të cilat Qendra Kinematografike e Kosovës mund të nënshkruajë marrëveshje për projekte të bashkëpunimit dhe të bashkëprodhimit të filmit.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të plotësojë infrastrukturën ligjore në fushën e kulturës dhe do të punojë në reformimin e saj, duke e përfaruar atë me praktikën më të mira ndërkombëtare, të vendeve të rajonit, si dhe të Bashkimit Evropian. Prioritet do të jenë hartimi dhe miratimi i Strategjisë për Kulturë, si dhe Ligji për sponsorizime dhe donacione, si dy dokumente mjaft të rëndësishme për zhvillimin e jetës kulturore në vend dhe prezantimin ndërkombëtar.

Kultivimi i relacioneve të veçanta kulturore me Shqipërinë dhe me vendet e tjera ku jetojnë shqiptarët do të thellohet. Tashmë, Kosova dhe Shqipëria kanë krijuar Kalendarin e Përbashkët Kulturor. Qeveria do të vazhdojë të angazhohet në zbatimin e këtij kalendari, duke e pasuruar dhe duke rritur buxhetin për aktivitet e përbashkëta, që organizohen përgjatë vitit në kuadër të tij.

Shtyllë tjetër tepër e rëndësishme e programit do të jenë politikat që do të garantojnë përmirësim të dukshëm të shërbimeve shëndetësore.

Gjatë këtij mandati, do të synojmë ndërtimin e një sistemi shëndetësor efikas, të mbështetur në resurse të qëndrueshme njerëzore dhe me një financim adekuat të qëndrueshëm, që siguron qasje të barabartë në shërbime cilësore dhe kosto efektive shëndetësore për të gjithë qytetarët.

Që të arrihet kjo, reforma e sistemit shëndetësor do të jetë e vazhdueshme duke promovuar politikat për përmirësimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve bazuar në nevojat e popullatës dhe në përputhje të plotë me standardet e Bashkimit Evropian për t'u siguruar qytetarëve shërbime shëndetësore të krahasueshme me popujt e rajonit dhe më gjerë.

Nën këtë prizëm, reforma e sistemit shëndetësor do të konsistojë në funksionalizimin më të mirë të sistemit shëndetësor me qytetarin në qendër të vëmendjes, ngritjen e efikasitetit të institucioneve shëndetësore në të gjitha nivelet, përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore, funksionalizimin e sigurimeve shëndetësore, shfrytëzimin optimal të resurseve profesionale në dispozicion nëpërmjet integritit të shërbimeve shëndetësore në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor, si dhe zhvillimin e kapaciteteve menaxheriale në kuptim të rritjes së përgjegjësisë, transparencës dhe llogaridhënies së strukturave menaxheriale.

Baza kryesore mbi të cilën do të mbështeten reformat e sistemit shëndetësor do të jetë fillimi i funksionalizimit të sigurimeve shëndetësore nga viti i ardhshëm. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se funksionalizimi i plotë i këtij sistemi kërkon kohë, Qeveria në 2 vjetët e ardhshme do të rrisë ndjeshëm financimin e sistemit shëndetësor publik duke synuar ngritjen e shpenzimeve publike për shëndetësi për kokë banori në nivelin e mesatares së vendeve të rajonit.

Me prioritet të lartë, Qeveria do të angazhohet në zbatimin e reformës përmbajtjesore dhe gjithëpërfshirëse në sektorin e shëndetësisë, të bazuar në Strategjinë sektoriale të Shëndetësisë 2014-2020 dhe moton e Bashkësisë Evropiane në sektorin e shëndetësisë “Politikat shëndetësore në të gjitha politikat”.

Synim kryesor i kësaj reforme është sigurimi i qasjes universale në shërbime cilësore shëndetësore për të gjithë qytetarët dhe banorët e vendit, si dhe eliminimi i pabarazive gjatë shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore.

Ndryshimi i sistemit të financimit të sektorit të shëndetësisë, nga modeli i centralizuar buxhetor, në modelin e kombinuar të financimit nga buxheti dhe sistemi publik dhe privat i sigurimeve shëndetësore, do të arrihet me themelimin dhe funksionalizimin e Fondit Publik të Sigurimeve Shëndetësore, që përveç tjerash, do të mundësojë:

Rritjen e buxhetit për Shërbimin Spitalor e Klinik Universitar të Kosovës përfshirë QKUK-në, spitalet e përgjithshme rajonale, institucionet e tjera shëndetësore të nivelit dytësor dhe tretësor; Rritjen e Grantit Specifik të Shëndetësisë për komunat; Sigurimin dhe furnizimin 100% me barna dhe material shpenzues mjekësor nga Lista Esenciale e Barnave dhe Materialit Shpenzues, që do të përpilohet në pajtim me standardet përkatëse ndërkombëtare, si dhe vlerësimit real të nevojave, e po ashtu edhe Funksionalizimin e plotë të Sistemit të Informimit Shëndetësor.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Besoj thellë se me përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës si tërësi dhe të çdo anëtarit të saj, me funksionalizimin më të madh të agjencive të pavarura dhe riorganizimin e tyre, me masat për përparimin e qeverisjes korporatave të kompanive publike do të sigurojmë një fillim të ri të qeverisjes së vendit, i cili do të jetë në të mirë të çdo njeriu që jeton në Kosovë dhe do të sigurojmë një ndërlidhje të fortë me bashkatdhetarët tanë jashtë vendit.

Roli i Kuvendit të Republikës së Kosovës është shumë i rëndësishëm për realizimin e objektivave dhe synimeve tona zhvillimore dhe shtetndërtuese. Prandaj, do të bashkëpunojmë ngushtë me ju, me të gjitha komisionet dhe trupat punuese të Kuvendit, në mënyrë që të rritet transparenca dhe llogaridhënia në procesin e qeverisjes me vendin.

Do ta rrisim rolin e Kuvendit në procesin e dialogut, në mënyrë që të gjitha vendimet nga dialogu të jenë transparente dhe të pranueshme nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Në Kosovë, sot çdo fushë është me prioritet; zhvillimi ekonomik, arsimi cilësor, shëndetësia cilësore, emancipimi kulturor, lufta kundër varfërisë së lartë, përkujdesa sociale; është me prioritet forcimi i shtetit ligjor, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, evitimi i çdo lloj ekstremizmi që dëmton raportet e brendshme dhe bashkëpunimin me popujt dhe vendet e tjera.

Prandaj, ne do të përqendrohemi në Zhvillimin e diversifikueshëm ekonomik, me rritje vjetore të normës së bruto-produktit vendor që siguron një herë stabilizim të papunësisë dhe në vijim uljen e papunësisë dhe zhvillimin gradual të vendit; do të punojmë në përmirësimin e bilancit tregtar me jashtë, përmes nxitjes së prodhimtarisë vendore, sidomos asaj të ushqimeve; do të punojmë në forcimin e shtetit ligjor, në të gjitha segmentet e tij, për të mundësuar jetë të qetë e të sigurt për qytetarin, dhe siguri për investitorë të jashtëm.

Do të punojmë shumë që të shfrytëzojmë të gjitha resurset e këtij vendi, të ndërtojmë partneritet me institucionet financiare ndërkombëtare dhe me qeveritë e vendeve mike për ta mbështetur zhvillimin ekonomik dhe për ta ngrit cilësinë e jetës së qytetarëve.

Partneriteti i përhershëm dhe special me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe partneritet i me vendet e Bashkimit Evropian do të zhvillohet edhe më tej dhe do të thellohet në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Në fokus të qeverisjes sonë do të jetë qytetari, atij do ti japim llogari nëpërmjet jush dhe drejtpërdrejt. Ju faleminderit!

Ju njoftoj që, pasi të përmbyllet debati, unë do ta prezantoj Kabinetin qeverisës të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar zoti Isa Mustafa, i nominuar për kryeministër të Republikës së Kosovës.

Tani të nderuar deputetë më lejoni të theksoj se futemi në etapën e hapjes së debatit. Paraprakisht kam për obligim, në bazë të Rregullores t'ju tregoj se në fillim do të paraqiten shefat e grupeve parlamentare, në fakt ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe pastaj do të hapet të njëjtën kohë edhe debati për ata të cilët janë lajmëruar deri tash për diskutime. Aktualisht i kemi 16 deputetë të nderuar dhe deputete që janë lajmëruar për diskutime.

E ftoj përfaqësuesin ose kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë më të madhe, Partisë Demokratike të Kosovës, zotin Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i jep mbështetje ekspozesë së paraqitur nga i nominuari për kryeministër të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Grabovci!

E ka fjalën përfaqësuesi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Po ashtu edhe ne i japim mbështetje të plotë ekspozesë së paraqitur nga mandatarin për Qeverinë e re, kryeministrit në ardhje, zotit Isa Mustafa. Faleminderit!

KRYETARI: E ftoj Grupin Parlamentar Vetëvendosje, zotin Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve vendëse dhe atyre ndërkombëtare,
Të nderuar ambasadorë,
Çdo gjë që e kemi thënë dhe e kemi argumentuar në mandatin e kaluar për qeverinë në largim, ka dalë të jetë e vërtetë.

Kjo qeveri ishte ajo e lulëzimit të korrupsionit në çdo skutë institucionale, qeveri e ngecjes ekonomike qasja e të cilës ka qenë që t'i bëjë rrush e kumbulla pasuritë dhe asetet publike të popullit të Kosovës, qeveri e kapjes së drejtësisë dhe të shtetit, qeveri që vjedh nga pasaportat e qytetarëve, qeveri që i futë duart në dhomat e dëshmimeve, qeveri e punësimeve nepotike dhe shpunësimeve shantazhuese, qeveri që ka arritur ta korrtojë madje edhe Misionin e BE-së në Kosovë për sundim të ligjit.

Se çfarë Kosove na e ka lënë kjo qeveri e Hashim Thaçit nuk ka nevojë as për mbrojtje pompoze, as për sulme frenetike. Nuk kemi nevojë për komente, sepse çfarë Kosove na e ka lënë qeverisja e PDK-së më së miri i tregojnë pamjet e trishtueshme të mijëra të rinjve të cilët shtyhen në mes vete për një vend në autobusin i cili ia mban kah Serbia në drejtim të kampeve të Hungarisë.

Kjo është zonja dhe zotërinj gjendja e Kosovës të cilën na e la keqqeverisja e pa shembull e pushtetit të deritanishëm.

Dhe nuk do mend se beteja e zgjedhjeve nacionale ishte një ballafaqim krejtësisht i padrejtë, sepse kishim të bëjmë me një luftë të barabartë. Në njërin anë subjektet politike me resurset e tyre vetjake, kurse në anën tjetër PDK-ja me mobilizimin e të gjitha aseteve shtetërore duke filluar nga punësimet e policëve një javë përpara zgjedhjeve e deri te drekat dhe darkat pa fund të arsimitarëve.

Kjo qeveri asnjë rrugë të vetme nuk e shtroi nëse kjo rrugë në të njëjtën kohë nuk përkthehej në vota. Asnjë shkollë nuk e ndërtoi nëse paraprakisht nuk e mori garancinë se kjo nuk shndërrohej në vota, sepse kjo qeveri nuk punoi për qytetarin, por punoi për vota. Vota që kthehet në pushtet, pushteti që kthehet në fuqi, fuqia që kthehet në kontroll, kontrolli që kthehet në para, paraja që kthehet në vota dhe kështu deri në pafundësi.

Ndonëse nëpërmjet këtyre metodave jodemokratike PDK-ja serish doli e para në zgjedhje, qytetarët vazhdimisht kanë kërkuar që të krijohet në Kosovë një fond i përbashkët politik për t'i dhënë fund njëherë e përgjithmonë kësaj metodologjie të qeverisjes e cila institucionet e pavarura shtetërore i kthen në organe të varura partiake, e

cila shërbyesin civil e bën militant partiak, administratorin e kthen në aparaçik, arsimtarin në agjitues, kurse mediet e caktuara i bën lustruese të keqqeverisjes.

Dhe, më 9 qershor lindi një shpresë e re për qytetarët e Kosovës, se mos Kosova po e merr një drejtim të ri, se mos po bëhen të gjithë bashkë për ta realizuar atë për të cilën ëndërronin qytetarët tanë, që t'i jepet fund krimit të organizuar politik, që të çlirohet drejtësia, që të marrë frymë ekonomia dhe punësimi, që matrapazët të ndëshkohen, kurse profesionistët të favorizohen. Dhe kjo shpresë zgjati për 5 muaj, deri në momentin që ky njeri i cili po zgjidhet sot kryeministër i Kosovës e bëri aktin më të shëmtuar e më të ulët që mund ta imagjinojë morali minimal publik.

Përgjatë viteve ai erdhi në krye të partisë së tij pikërisht duke u thirrur në kundërshtimin e PDK-së. Elektorati i brendshëm i pakënaqur me LDK-në e atëhershme e hoqi bile edhe Fatmir Sejdiun dhe e solli në krye këtë njeri. Ai mundi t'i bashkohej PDK-së edhe në vitin 2010 po tha: dua të qëndrojë në opozitë dhe jo me Hashim Thaçin dhe për katër vjet me radhë vrapoi sa në një kënd në këndin tjetër të Kosovës duke e vjedhur votën e elektoratis të pakënaqur me Qeverinë Thaçi 2 dhe iu tha njerëzve, ma jepni votën tuaj, sepse do t'i jap fund keqqeverisjes kriminale të PDK-së.

Kur i mori të gjitha ato vota, por nuk fitoi i trembur dhe i frikësuar deri në palcë nga trusnia e dorëheqjes, u bashkua me bllokun politik të 9 qershorit. Ama, zonja e zotërinj, deputetë të këtij Kuvendi ky njeri në asnjë sekondë nuk paska qenë i singertë.

Si mundi ai ta keqpërdorë shpresën e qytetarëve për ndryshim dhe të shkojë bashkë me këtë bagazh të shpresës së popullit e ta negociojë me Hashim Thaçin, postin e vet për kryeministër? Si pati guxim vallë ky njeri ta shpërdorë kaq mizorisht vullnetin e shoqërisë për ndryshim dhe ta marrë krejt këtë vullnet e t'ia dorëzojë në tavolinë njeriut që është simbol i keq qeverisjes së deritanishme.

Si munde ti zoti Mustafa të tregosh kaq pak skrupuj për dëshirat më të singerta të qytetarëve tanë? Ju zoti Mustafa e luajtët rolin e kumarxhiut me vullnetin e popullit.

Mendoj që ju tash keni përfunduar në vagon të Hashim Thaçit. Kjo është një mënyrë krejt e palavdishme për t'i dhënë fund karrierës së ardhshme politike, kjo është një mënyrë fatkeqe bile edhe për vendin tonë. Dhe, krejt e bëtë kryekëput për ambicie personale. S'ka lidhje ku mbeten qytetarët, s'ka lidhje ku mbetën premtimet me të cilat i mbledhët votat, tek e fundit, edhe partia s'ka lidhje ku mbetet, me rëndësi është që u bëtë vagon i Partisë Demokratike të Kosovës.

Atëherë, si mund t'i besojnë qytetarët këtij njeriu i cili i mashtroi ata duke iu premtuar: kurrë me PDK-në. Si t'i besojnë këtij kur shpalli luftë kundër korrupsionit, kur vetë po i bashkohet atij, si t'i besojmë që do të qeverisë mirë kur vetë iu bashkua keq qeverisjes.

Në fund, po e përmbyll duke thënë që jam plotësisht i pajtimt me atë thënien famoze të cilën e kumtoi në një natë të nxehtë gushti orakulli i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ismet Beqiri, i cili tha: koalicioni PDK-LDK është katastrofë për Kosovën.

Është e vërtetë sepse ky është koalicioni i dosjeve, ky është koalicioni i shpërdoruesve të Fondit “Vendlindja thërret” me matrapazët e 3%, pra i atyre që e qethën këtë popull para luftës bashkë me ata që e qethën gjatë luftës dhe pas luftës.

KRYETARI: E ftoj përfaqësuesen e Grupit Parlamentar AAK, zonjën Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar mysafirë,

Kosova kishte dy rrugë para vetes, integrimet në Bashkimin Evropian dhe izolimin. Sot pas vendimit për këtë koalicion, shpresat e qytetarëve të Kosovës për integrim, për prosperitet, për zhvillim ekonomik, për arsim kualitativ e të mos flasim për sundim të ligjit, janë shuar.

Sot Kosova ka në krye të legjislativit dhe ekzekutivit dy figura që gërshetojnë komunizmin, nëntokën dhe shërbimet sekrete.

Këso lloj udhëheqje ne mund të shohim diku në Kolumbi ose në Rusi, ose në Kubë, por asnjë vend në Bashkimin Evropian nuk ka këso lloj udhëheqje.

Është një kombinim Putin - Eskobar - Kastro dhe nuk mund të dalë asgjë e mirë nga ky kombinim. Me këta emra të cilët kanë mbushur data bazat e shërbimeve inteligjente mike të Kosovës si figura të dyshimta për krim nga më të ndryshmet, popullit të Kosovës sot nuk po i bëhet nderë. Njerëz të cilët kanë mbushur kryetitujt e medieve të vendeve mike për veprimet e tyre të dyshimta kriminale nuk i bëjnë nderë Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

A s’ka pasur Kosova njerëz që do të udhëheqin me duar të pastra pa qenë subjekt i hetimeve, njerëz të cilët do të jenë kokë lartë në takimet vendore dhe ndërkombëtare dhe prej të cilëve qytetarët e Republikës së Kosovës nuk do të skuqen. Ka pasur njerëz të cilët 100% e kohës së tyre do t’u kushtojnë detyrave që dalin nga pozitat e tyre udhëheqëseve dhe jo njerëz të cilët kohën më të madhe do ta kalojnë duke menduar se si do të përballen me akuza dhe si t’u ikin atyre.

Në vend të tyre ne sot kemi njerëz në këtë koalicion dhe në këtë klasë politike nëpërmjet të cilëve në Kosovë do të rritet varfëria, do të thellohet kapja e shtetit, do të shtohen autobusët në Suboticë që po i shohim përditë dhe që po bartin rininë, po bartin qytetarin e Kosovës edhe në të zezën duke e rrezikuar jetën e tyre. Dhe, përgjegjës për të gjitha këto janë të gjithë ata deputetë të partive politike të cilët sot vendosën që të përkrahin këtë koalicion dhe ta rikthejnë në pushtet Hashim Thaçin dhe klikën e tij.

Edhe ata të cilët sot nuk votuan, por abstenuan duke provuar që të mashtrojnë një pjesë të elektoratit të partive të tyre, më besoni këtë e bënë vetëm me qëllime që edhe një herë, ashtu si shumë herë më parë, ky elektorat që mashtrohet.

Krejt për fund, se sa i mjerë ishte edhe prezantimi paraprak dhe sa fals ishte, kur u përmend me shumë se tri herë përfaqësimi i gruas dhe i të drejtave të saj, zhvillimi dhe punësimi, do të shohim pas pak, kur ta shohim përbërjen e Qeverisë, në të cilën ka tepër pak gra.

Personalisht, unë nuk jam befasuar për këtë, sepse kjo Qeveri nuk do të jetë asgjë tjetër, përveç edicionit të dytë të librit të famshëm 'mek-mafia', në të cilën të rinjtë, intelektualët e gratë nuk kanë hapësirë. Ata zakonisht janë viktimat e këtij sistemi.

Në këtë Kuvend, të nderuar kolegë deputetë, nuk do të ketë as demokraci, as sundim të ligjit, e po ashtu në këtë Qeveri nuk do të ketë llogaridhënie dhe nuk mund të presim ditë më të mira.

Koalicioni, i cili është bërë në terr, e ka thelluar errësirën, e cila e ka mbuluar Kosovën, dhe do të hiqet vetëm në një ditë, në një mëngjes të bukur, kur gratë dhe burrat e këtij vendi, qytetarë të ndershëm, të cilët kanë pritur me muaj të tërë që t'u kthehet shpresa, shpresë të cilën e tradhtoi Lidhja Demokratike e Kosovës dhe kryetari i saj, do të ngrihen të bëhen bashkë dhe ta luftojnë këtë të keqe.

KRYETARI: E ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar Nisma për Kosovën, Jakup Krasniqi, ish-kryetar i Kuvendit.

JAKUP KRASNIQI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të nderuar diplomatë dhe mysafirë,
Nuk do të ndalem në të kaluarën, se edhe për atë u tha mjaft, por kryesisht do të them për këtë që na pret ne dhe për atë që i pret qytetarët e Republikës së Kosovës.

Edhe pse Kosova tash e 15 vjet nuk është në gjendje të jashtëzakonshme, nga viti 2007 e këndeje, të gjitha seancat themeluese për zgjedhjen e Kabinetit qeveritar janë mbajtur të jashtëzakonshme. Ndoshta seancat e parafundit për zgjedhjen e Kabinetit qeveritar, për shkak të numrave, është dashur ta shfrytëzojnë seancën e jashtëzakonshme për ta zgjedhur Qeverinë, por nuk e kuptoj pse këtij koalicioni të madh, që ka diku mbi 85 numra, i ngutet dhe me seancë të jashtëzakonshme ta zgjedhë Kabinetin qeveritar.

Neve nuk na pengon bërja e këtij koalicioni të panatyrshëm qeveritar sepse, në fund të fundit, vetë krerët e këtyre partive dhe përfaqësuesit e tyre jo pak herë e kanë quajtur koalicion të panatyrshëm dhe të gjitha kërkesat për vota i kanë bërë, sidomos Lidhja Demokratike, për ta ndryshuar qeverisjen, e jo vetëm kaq, por edhe sot përfaqësuesit e këtij subjekti politik me termat më të rëndë, të cilët në kushte normale, pa i shqiptuar gjyqi, nuk do të duhej të shqiptoheshin nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, me gjithë ato aktakuza e akuza u thanë edhe janë thënë në vazhdimësi dhe janë të pandershme. Pse janë të pandershme?

Këto dy parti e kanë bërë një koalicion të madh për t'i dhënë një qeverisje të mirë vendit, por qeverisja e mirë nuk mund t'u vijë qytetarëve të Kosovës nga partitë që janë të përfaqësuar në këtë Kuvend, me njerëz me moral dyfishtë. Tjetër mendon, tjetër thotë, e

tjetër vepron! Kjo për politikën është e pandershme dhe unë s'mund ta quaj me emër tjetër.

Mandatarin e mbajti një fjalë të gjatë për një qeverisje të mirë, për një qeverisje në shërbim të qytetarëve, por në vend se t'i thoshte edhe emrat e kandidatëve për Kabinetin qeveritar, ai e la këtë për më vonë. Por, ne mund të flasim për këtë Kabinet qeveritar nga ajo që kemi lexuar sot në media, dhe as në formë, as në përmbajtje, ky koalicion qeveritar nuk garanton se në Kosovë do të ndërtohet shteti i së drejtës.

Ky koalicion qeveritar, as në përmbajtje e as në formë, nuk garanton se ky vend do ta ketë një zhvillim ekonomik.

Ky koalicion qeveritar, as në formë dhe as në përmbajtje, nuk garanton që do të ketë një rishikim të privatizimit, i cili është i kriminalizuar dhe nuk ka arritur asnjë efekt në zhvillimin ekonomik dhe në zvogëlimin e papunësisë.

Ky koalicion qeveritar, as formë e as përmbajtje, nuk afron për qytetarët tanë një arsim të mirëfilltë, në përgjithësi, e sidomos një arsim të lartë të mirëfilltë, i cili vërtet është në një krizë të madhe dhe duke qenë ky nivel i arsimit në këtë krizë, Kosova nuk ka perspektivë as në zhvillimin ekonomik, as në zhvillimin e demokracisë dhe as në sundimin e ligjit.

Ky koalicion qeverisës nuk ofron sundimin e rendit dhe të ligjit dhe është një vazhdim me të vjetrën.

Është edhe diçka tjetër, që dua ta them. Gjatë gjithë parafushatës dhe fushatës zgjedhore, të gjitha shigjetat që janë drejtuar ndaj 'Nismës', në përgjithësi, dhe mua, në veçanti, janë udhëhequr me akuzën se vota për ne do të jetë votë për Isa Mustafën dhe pastaj i kanë thënë lloj-lloj epiteteve Isa Mustafës, të cilat ai i di më mirë se unë.

Dhe, po ata që na akuzuan në kontinuitet për diçka të tillë, më në fund, ose po ai, doli dhe e propozoi për mandatar për katër vjetët e ardhshme në Qeverinë e Kosovës. Edhe kjo vërtetë është një pandershmëri e skajshme.

Gjatë leximit të ekspozesë së mandatarit e krijova përshtypjen se ai nuk e di cili është Buxheti i Republikës së Kosovës, cila është shuma e atij buxheti dhe si do të shfrytëzohet dhe do të menaxhohet ai buxhet. Ai foli sikur Buxheti i Kosovës të ishte nja 150 miliardë euro, e jo një miliard e gjysmë. Prandaj, mua më vjen keq, por një mandatar që nuk e di se sa është Buxheti i Kosovës dhe flet se çfarë do të fitojë Kosova, e kam bindjen që Kosova s'do të fitojë asgjë.

Mandatarin duhet ta dijë që Kosova është në vendin e nëntë prej vendeve më të varfra në kontinentin tonë. E të mos flasim se Kosova është vendi më i varfër në Kontinentin e Vjetër, pra në Evropë. Prandaj, pak jep shpresë se ky mandatar do të dijë ta qeverisë vendin.

Mandatarin foli se Qeveria do ta përmirësojë Gjyqësorin në Kosovë, sistemin e drejtësisë. Qeveria nuk ka nevojë ta përmirësojë, as ndërhy në sistemin e drejtësisë. Qeveria dhe koalicioni qeverisës janë të obliguar ta kenë vullnetin politik që të mos ndërhyjnë në sistemin e drejtësisë, e në mënyrë të veçantë të mos ndërhyjnë në Gjyqësor, se nëse Qeveria vazhdon të kujdeset për Gjyqësorin dhe të ndërhyjë në të, lufta kundër krimit dhe korrupsionit, që u shpalos nga mandatarin, nuk ka asnjë kuptim.

Mandatarin foli edhe për programin qeveritar, por harroi të na thotë se cila do të jetë përbërja e këtij Kabineti qeveritar. Nga ajo që, përsëri duhet ta them, në media u tha se ky kabinet do t'i ketë diku 20 e më tepër ministri, e mospjesëmarrja e komunitetit serb tregon se lufta është për akomodim të njerëzve dhe lufta edhe ndërmjet dy subjekteve që e kanë bërë koalicionin ka qenë për akomodim të njerëzve, e jo luftë për ta krijuar një Kabinet qeveritar që do ta marrë përgjegjësinë për ta ndryshuar dhe për të qenë në shërbim të qytetarëve të Kosovës.

Mandatarin harroi të na thotë se ky Kabinet qeveritar nuk është bërë për ta ndryshuar qeverisjen në vend, nuk është bërë për ta ndryshuar zhvillimin ekonomik të vendit, nuk është bërë për ta përmirësuar arsimin dhe shëndetësinë në Kosovë, por është bërë për tri çështje kryesore, dhe është dashur t'i thotë, e nga këto çështje kryesore nuk e tha asnjërën.

Këtij Kabineti qeveritar nuk i intereson jeta e qytetarëve të Kosovës. Sigurisht nuk u intereson as atyre që e kanë mbështetur këtë Kabinet qeveritar...

KRYETARI: E lus regjinë t'ia lejojë fjalën edhe tre minuta.

JAKUP KRASNIQI: Është formuar për Gjykatën Speciale, për të shpejtuar formimin e saj. Është formuar për t'i realizuar marrëveshjet që janë arritur gjatë katër vjetëve në Bruksel dhe për dialogun.

Ky koalicion qeveritar këto tri detyra e tri përgjegjësi i ka marrë. Nëse mund t'i kryejë, ndoshta do të shpallet, ose do të vetëshpallet i suksesshëm, por ky koalicion qeveritar, e them me bindje, nuk është bërë për ta ndryshuar gjendjen ekonomike, sociale, shoqërore dhe demokratike në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Faleminderit i nderuari kryetare,

Saygıdeğer başkan, saygıdeğer milletvekilleri, saygıdeğer büyükelçiler, değerli basın mensupları.

Öncelikle Kosova Meclisinin ve kurumlarının kurulmasını tebrik ediyor, Kosovaya ve Kosova halkına hayırlı olmasını diliyorum. Elbette bizler de 6+ grup çerçevesinde Türk, Boşnak, Rom ve Aşkali milletvekilleri olarak buluştuk ve ebraber sayın başbakan adayı Sayın İsa Mustafanın sunduğu programa destek verdiğimizizi ve bu program içerisinde de sorumluluk ve yükümlülüklerimizi yerine getirmeye hazır olduğumuzu bildirmek istiyorum. Bu toplumlar olarak her zaman yapıcı rolümüzü üstlendik, bunu da

sergilemeye hazırız çünkü Kosova Cumhuriyeti bir vatanımız olarak tüm şahirleriyle berber, tüm insanlarıyla beraber daha iyi bir yaşam hepimiz yaratmalıyız. Bu anlamda da yeni hükümetin ve sunulan programında bu çerçevede yardımcı olacağını ve Kosova halkına en iyi cevabı vereceğini inanıyorum. Bizler de bu konuda tekrar çalışmaya hazır olduğumuzu ifade ederken hepinize tebrik ederken saygılarımı sunarım.

KRYETARI: Ju falënderoj shumë! Tani ka mbaruar pjesa e diskutimeve nga grupet parlamentare. Do të vijojnë tani diskutimet e deputetëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës. Ju lutem, janë nga 10 minuta, kisha pasur dëshirë t'j respekti. Unë jua ndali fjalën, por jua ndal regjia, prandaj të jeni të kufizuar në këta minuta.

Pasi po e shoh se nuk është kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, le të vijë kryetari i "Vetëvendosjes", është paraqitur për diskutim. A dëshironi ta shkurtujmë minutazhin? Atëherë shkojmë kështu, në bazë të radhitjes, Donika Kadaj-Bujupi ka qenë e para. Ju lutem, Ramush Haradinaj e ka fjalën.

RAMUSH HARADINAJ: Deputetë të nderuar,
Mysafirë,
Qytetarë të vendit,

Në ditën e nisjes të një qeverie mendon se çka do t'j sjellë vendit ajo qeveri dhe gati pyetja kryesore është se çka do të ndodhë nga kjo ditë? A do të ndodhë diçka, si do të ndryshojë jeta? Mirëpo, për të mundur të ndodhë puna që të ndodhë ndryshimi janë disa parametra të nevojshëm, pa të cilët është e pamundur të ndodhin pritjet e qytetarëve, goftë edhe të politikanëve. Janë parametra bazë realë, të cilët nuk gabojnë, nuk e japin të kundërtën.

Sa i përket gjendjes në vend, të mos harrojmë se Kosova ka ardhur në një shkallë të keqe dhe për këtë gjendje në vend, meritore më së shumti, ka edhe të tjerë, por më së shumti është PDK-ja, e kryesuar nga zoti Thaçi me kolegët e vet, kuptohet edhe me bashkëpunëtorin e tij, Veselin. Pra, janë meritore për këtë gjendje të rëndë në vend.

Këtë besoj se askush në vend nuk e konteston sot. Ndërsa ndryshimi i kësaj gjendjeje, pra gjendja në të cilën e kanë sjellë qytetarin në vend, në të cilën ka ardhur Kosova, zbehjen e fitoreve, të meritave dhe të arritjeve të vendit, pra nuk mund të lavdërohen se i kanë sjellë e fitore vendit, mund vetëm të lavdërohen. Duke qenë të proceseve, i kanë zbehur këto fitore. I kanë sakrifikuar njerëzit e vendit kur është dashur, kanë bashkëpunuar me të gjithë për t'j dëmtuar të mirët e vendit, vetëm që të këqijë të mbeten në pozita udhëheqëse dhe t'j dëmtojnë fitoret e vendit.

Çfarë ka ndodhur tash? Janë bashkuar të këqijë dhe të dobët. Kush janë të dobët në këtë rast? Mos harroni, janë ata që gjithë kohën kanë kërkuar ta marrin meritën e viktimës. Janë ata që e kanë drejtuar gishtin te shumëkush, e në fund e kanë dorëzuar flamurin e viktimës. Për çka? Kuptohet, thjesht - për pushtet. Në rregull! Si do t'ua shpërblejnë këta këtë dorëzim njerëzve që u kanë besuar, qytetarëve të vendit? Sa mirë do të punojë 'Qeveria Mustafa-Thaçi'? Sa mirë do të punojë 'Parlamenti Veseli'? Sa mirë do

të funksionojë rendi dhe ligji në këtë Kosovë? E sa do të na përkrahin e respektojnë jashtë Kosovës me këtë gjendje?

Mua më vjen keq që sa herë ka ardhur mundësia në vend që të ndodhë ndryshimi, të këqijtë janë bërë bashkë - i keqi dhe i dobëti janë bërë bashkë. Nuk është hera e parë, ka pasur edhe raste tjera kur janë bashkuar forcat, kur janë bashkuar njerëzit, kur e kanë ditur se çfarë po duan - i keqi dhe i dobëti janë bërë bashkë. Pse? Sepse, ata më së miri ia dinë dertin njëri-tjetrit, ia dinë të bërat njëri-tjetrit, ia dinë fajet njëri-tjetrit dhe do t'ia ruajnë njëri-tjetrit. Deri kur? Populli thotë se i vjen dita gjithëçkajes.

Ajo ditë do të vijë, nuk është e largët. Kosova do ta sjellë atë ditë. Kosova ka njerëz të mirë e të ndershëm. Qytetari i vendit është i mirë dhe i ndershëm, nuk do t'i lërë të keqen e të ligën që ta zotërojnë e ta mashtrojnë vendin non-stop. Pra, unë çfarë kam parë këto ditë në politikë dhe çfarë kam parë gjatë kësaj përpjekjeje, edhe fjalimi i zotit Mustafa, nuk flas për të si njeri e familjar. Ju kërkoj falje të gjithë atyre që kanë ndjenja njerëzore, familjare e kolegjiale, por si politikan. Nuk e di si do të mund ky njeri t'i prijë Qeverisë së vendit me 50% të papunë të rinj, nuk di si do mundet ky njeri, më shkoi mendja kah lexonte, thashë mos e ka futur edhe një herë në plan ta rishtrojë sheshin e Prishtinës, se e mbaj mend atë shesh, e ka pas bërë Ismeti, ky e ka prishur dhe e ka bërë edhe një herë. Pra, nuk di si mund të bëjë punë të tjera në vend në këtë gjendje që është.

Meqenëse jemi kështu, unë dua t'ua jap një premtim - së pari dua të rri në Parlament gjithë kohën, aq sa të zgjasë ky parlament e këto institucione dhe dua të punoj që t'jua shkurtoj juve kohën që i mbani përgjegjësitë për këtë popull. Dua të punoj me secilin në këtë vend dhe nuk do të përtoj t'i shërbej secilit që punon për ta ndryshuar këtë gjendje.

KRYETARI: E ftoj Ilir Dedën, nga grupi parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”.

ILIR DEDA: Të nderuar deputetë,

Të nderuar mysafirë,

Zonja dhe zotërinj,

Është për keqardhje të jashtëzakonshme që ne sot nuk e morëm programin qeverisës. Është praktikë parlamentare demokratike që kur promovohet një qeveri, deputetëve t'u jepet plani i vet, plan-programi, për të cilin po e kërkojnë votëbesimin dhe të na tregojnë, ta dimë të paktën se kush janë ata individë me të cilët kandidati për kryeministër dëshiron t'i mbërrijë ato synime, apo qëllime, apo çfarëdo qoftë. Fatkeqësisht, kjo nuk ndodhi, dhe kjo e tregon joseriozitetin e koalicionit LDK-PDK.

Po çfarë dëgjuam ne sot nga një listë fontanë dëshirash janë tri zotime, tri synime, tri përkushtime, një promovim dhe dy fakte, të cilat kanë të bëjnë me atë se Qeveria e ardhshme do të jetë e vetëdijshme për vështirësitë në Kosovë, por megjithatë nuk e dëgjuam asnjë obligim të Qeverisë së re për situatën në Kosovë, e ky program i cili u lexua para nesh, apo kjo fontanë dëshirash, është në shpërputhje të jashtëzakonshme me realitetin në Kosovë.

A mund disi ndryshe të përshkruhet realiteti i Kosovës se sa 24 orë pas promovimit të koalicionit PDK-LDK qytetarët e Kosovës filluan të ikin në drejtim të Hungarisë, e deri tash janë 5000 sish për tri javë, por ne kemi histori me ikje, por ikja e sotme është tragjike, sepse sot qytetarët e Kosovës e shesin pronën e tyre, më përpara përfundojnë në burgje në Hungari, se sa që presin që në Kosovë jeta e tyre të përmirësohet. Këtë nuk e përmendët zoti Mustafa!

Mos harroni se në vitet e '90-ta qytetarët kanë ikur, por nuk e kanë shitur pronën, sepse kanë pasur shpresë. Ajo çfarë keni bërë ju me Partinë Demokratike të Kosovës - ua keni mbytur shpresën qytetarëve të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, LDK-ja ka premtuar se do të ketë diskontinuitet në qeverisje. Me veprimet e veta në tri javët e fundit, ne po e shohim se LDK-ja po garanton vazhdimësi, vazhdimësi dhe kontinuitet në këtë qeverisje me vendin tonë.

Për në pyetje janë 6 çështje, për të cilat gjithashtu nuk morëm përgjigje. E para, si do të sillet Qeveria e re (e vjetër) me mbrojtjen e interesave vitale të Republikës së Kosovës dhe këto a do të shkojë drejt rrugës Bosnjës 2 apo jo, konkretisht Bashkësia e Komunave Serbe, të cilën ju do ta zbatoni, a do të jetë OJQ, apo jo?

E dyta - a mund kjo Qeveri ta anëtarësojë Republikën e Kosovës në Kombet e Bashkuara brenda dy vjetësh? Nuk e dëgjuam këtë, por tha se është synim. Dhe tre, e kjo është jashtëzakonisht interesante, çfarë është qëndrimi i pjesëtarëve të LDK-së në Qeverinë e re në forumet rajonale, ku Kosova prezantohet me fusnotë? Ju si parti politike keni qenë ndër kritikët më të mëdhenj, por jo më të mëdhenjtë, të fusnotës para disa viteve.

Sundimi i ligjit - nuk dëgjuam asgjë, përveç dëshirave, fjalë gjenerale, cilët janë ata hapa konkretë me të cilët Qeveria e re do ta luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar? A do të ketë sponsorizim të pakos anti-mafia të ligjeve, apo jo? A do t'ia lini opozitës që ta sponsorizojë këtë pako, apo jo? A do ta rritni buxhetin e agjencive përgjegjëse për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, apo jo? Nuk e morëm as këtë përgjigje!

Tjetra, gjithashtu indikative: Ju thatë Qeveria e re do të punojë në përmirësimin e imazhit të Republikës së Kosovës jashtë. E kush e ka prishur imazhin e Republikës jashtë vendit tonë? Ju deri para 3 javësh keni thënë Partia Demokratike e Kosovës. Pse nuk po tregoni se si do ta rregulloni këtë imazh në bashkëqeverisje me dikë që ju vetë 5 vjet e keni akuzuar për prishje dhe rrënim të jetës në Republikën e Kosovës.

Nuk e morëm vesh kur thatë: duam zbutje të papunësisë. A do të jeni në gjendje t'i punësoni 25 deri 35 mijë njerëz në vit që të zbutet papunësia? Nuk e morëm vesh cilët janë ata hapa të cilët do të ndërmerren për rritje 6 deri 8% të zhvillimit ekonomik në vit. Nuk e morëm vesh cilat janë ato fusha strategjike për rritje të prodhimtarisë në Kosovë. Nuk morëm vesh se çka me të vërtetë do të bëhet për zhvillim të arsimit në Republikën e Kosovës. Nuk morëm vesh si do të vijë deri te depolitizimi i Administratës Publike, e në marrëveshjen tuaj të koalicionit ju i keni ndarë të gjitha, apo jeni zotuar se së bashku do t'i ndani gjysmë për gjysmë, çdo agjenci të themeluar nga Kuvendi dhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ky nuk është depolitizim.

E çfarë u bë me demokracinë? Çfarë u bë me lirinë e medieve? Çfarë u bë me mbikëqyrjen e punës së Parlamentit ndaj Qeverisë? Këto mbetën pa përgjigje. Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës i kanë numrat në Kuvend dhe janë qeveri e një shumice parlamentare, por kjo shumicë parlamentare nuk reflektohet me përkrahje shumicë në popullin e Kosovës dhe ne ndodhemi në paradoks, ku pozita në Kosovë ka më shumë përkrahje popullore se sa Qeveria, e cila do të krijohet nga dy partitë më të mëdha.

Mos harroni se vetë keni qenë ata të cilët për 5 vjet keni thënë ‘në asnjë mënyrë me PDK-në, sepse me PDK rrënohet demokracia në Kosovë’, e sot nuk po e përmendni çështjen e demokracisë dhe, në fund - në çdo të keqe, në çdo terr ka diçka të mirë, e ajo e mirë është se kjo Qeveri, ky bashkim juaji faktikisht do të shtyjë deri në kundër-reaksion dhe gjithë potenciali demokratik intelektual, të cilin e ka Republika e Kosovës, të cilin e ka populli i Kosovës, do të bashkohet që të rezistojë dhe që të mos ju lejojë që të keq qeverisni për 4 vjetët e ardhshme. Faleminderit!

KRYETARI: E ftoj deputetin Pal Lekaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

PAL LEKAJ: Të nderuar deputetë,
Të nderuar përfaqësues ndërkombëtarë,
Qytetarë të Republikës të Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,

Ku t’ia fillojmë së pari? Është vështirë. Në ekspozenë që e bëri Isa Mustafa për ata që analizojnë - është skelet, dhe nuk ka fillim dhe nuk ka mbarim. Ka poezi ekonomike, por ajo që u ofron qytetarëve unë mendoj se është më e keqja e mundshme. Pse e them këtë? Ku janë, meqë nuk u përmenden 320 mijë vende të punës, 200 mijë nga PDK-ja dhe 120 mijë nga LDK-ja. Ku janë skemat sociale që vetëm në sipërfaqe i përmendi?

Dhe, ku është ai zhvillim ekonomik, meqë së paku u përmendën politikat fiskale, që e mbrojnë prodhimtarinë vendore. I përmendi disa grumbullime, që mund të them se do të prodhojnë vetëm ushqim për kafshë, e jo për njerëz, se ato do të kalben dhe nuk pati ndonjë strategji. E përmendi arsimin, por nuk e përmendi ndonjë reformë thelbësore, apo të thellë në arsim, që i duhet vendit. Fare nuk e përmendi, sepse ju e dini që çfarë katrohure është arsimi i lartë privat, çfarë katrohure ekziston arsimi i lartë publik. Dhe, këtë nuk e përmendi fare dhe m’u duk thua se jetojmë diku në një vend të Evropës.

Nuk e përmendi varfërinë, që jemi vendi më i varfër në Evropë, apo mund të them edhe në botë. Nuk e përmendi gjithë atë katrohurë në shëndetësi, që është mjerimi i Kosovës. Sot pacienti nuk ka ku t’ia mësyjë. Duhet ta ketë xhepin e thellë dhe të drejtohet në shëndetësi për të marrë shërbime parësore, sekondare dhe terciare. Dhe, thua se prapë nuk jetojmë në Kosovë dhe nuk e dimë.

Ajo që lirshëm mund të them, ku janë ato debatet e nxehta, që e keni quajtur këtë qeverisje të keqe, këtë qeverisje kriminele, që e ka fundosur shtetin. Ku janë zotimet e juaja, të nderuar LDK? Ku është zotimi juaj, i nderuar zoti Mustafa, që do të bëjmë ndryshim në qeverisje?

Kjo është një vazhdimësi e kësaj qeverisjeje dhe mund të them, që është vazhdimësi e zotit Thaçi 3, dhe asgjë tjetër, sepse ju keni ardhur me duar në xhepa dhe do të përfundoni prapë me duar në xhepa.

Ku është ky mjerim? Që prej sot mund të them, që jo vetëm 3-4 autobusë, por edhe shumë më tepër do ta lëshojnë Kosovën, sepse ky program qeverisës nuk ka të bëjë fare me zhvillimin e vendit dhe nuk ka të bëjë fare me ndërtimin e shtetit. Nuk ka të bëjë fare me ndershmërinë politike dhe na keni humbur edhe atë komunikim me qytetarët, që na thonë: “mos na flisni më për moral politik”, sepse ju jeni ata që e keni fundosur këtë ndershmëri politike. Ka moral edhe në politike, ka moral edhe në qeverisje, ka moral në të gjitha porët e jetës, por këtë e keni fundosur ju, sepse ju e bëtë atë më të keqen të mundshme për vendin, i dhatë fuqi keqqeverisjes së vendit, prandaj qytetarëve të Republikës së Kosovës ju them: Ju ndihmoftë Zoti, sepse me këtë qeverisje vështirë që mund t’ia dalim! Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

U përmend këtu, por mendoj se duhet të përmendet prapë, sepse është vërtet një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme, që në çfarëdo praktike sado të thjeshtë parlamentare do të duhej që të diskutonim dokumente dhe, këtu dokumentet mungojnë.

Në fakt, sot po kërkohet vota nga deputetët për një Kabinet qeveritar, me një mandatar për kryeministër dhe as nuk na tregohet se cili ka me qenë ai program, në bazë të cilit do të punojë kjo qeveri, përveç një ekspozite të mandatarit dhe as nuk na tregohet kush kanë me qenë ata persona që kanë me e zbatua atë program e aq më pak na tregohet, se si do të zbatohet ai program.

Dhe, është vështirë të diskutohet në këso gjendje, ose në këso situatë, në çfarë është vendosur Kuvendi i Republikës së Kosovës sot, po sidoqoftë e patëm një ekspozitë këtu nga mandatarin për kryeministër të Kosovës, në të cilën edhe kjo u përmend, por mendoj se duhet të përmendet prapë, u tha pak a shumë për ta përmbledhur, që do t’i bëjmë të gjitha. Pra, mandatarin tha që për këtë mandat, i cili mund të jetë katër vjet maksimalisht, por mund të jetë tre, dy ose një, tha do t’i bëjmë të gjitha mungesat që janë deri tash në Kosovë, në secilin rrafsh, që prej ekonomikut deri te politika e jashtme, te politika e brendshme, sundimi i ligjit, çështjet e bujqësisë, tek ato të kulturës, të sportit e kështu me radhë. Pra, dy javë këto dy subjekte e kanë terrorizuar, të them ashtu, qytetarin e Kosovës, duke mos treguar se kush do të jetë kandidati për kryeministër apo për ministra dhe duke thënë se po e shfrytëzojnë këtë kohë për ta dakorduar programin qeverisës mes vete dhe në fund na dolën që në fakt çfarë paskan bërë këta që dy javë, i paskan listuar të gjitha problemet e Kosovës.

Dhe, erdhi këtu mandatarin e na tregoi se cilat janë problemet e Kosovës, jo vetëm neve, por edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës, atyre që jetojnë me këto probleme përditë. Dhe, mendoj që identifikim të problemeve nuk ka pasur nevojë të bëhet nga mandatarin, sepse pak a shumë të gjithë i dimë ato probleme të cilat janë.

Kur thuhet kështu, kjo tregon që në fakt nuk ka kurrfarë serioziteti e as mendimi në këtë qeveri, pra kjo tregon që kjo qeveri nuk e ka qarë fare kokën për atë se çfarë do bëjë dhe kanë qenë të fokusuar gjatë tërë kohës që ta marrin vesh cili prej tyre do ta zë cilin post ministror dhe kush prej tyre do të jetë kryeministër.

Pra, ky paska qenë diskutimi gjatë këtyre dy javëve. Natyrisht, kur thuhet se do t'i bëjmë të gjitha dhe kur kjo fjali nuk është paralajmërim për një tragjedi, atëherë është komike, por fatkeqësisht, këtu në Kosovë është e para, ky është paralajmërim për një tragjedi.

Çështja e dytë, meqenëse nuk u prezantuan këtu kandidatët për ministra, apo edhe përbërja e Qeverisë, por meqenëse gjithashtu është raportuar nëpër medie për një përbërje të mundshme të Qeverisë, qoftë me emra ministrash apo edhe me dikastere qeveritare, atëherë s'kam qare pa i ngritur dy çështje edhe për këtë.

Së pari, duket se partnerët e koalicionit janë dakorduar që ta krijojnë një ministri të re, e cila do të jetë ministria ose ministri i shtetit, pra njëfarë ministri pa portofol dhe i cili do të jetë përgjegjës për dialogun me Serbinë. Pra, në këtë mënyrë dialogu me Serbinë tashmë po bëhet edhe çështje e brendshme e Kosovës, por njëkohësisht po bëhet edhe e përhershme, sepse kur krijon ministri për një sektor, do të thotë që ai sektor do të vazhdojë së jetuari në jetën politike vazhdimisht, nuk është një çështje që mund të përfundojë me një ose dy marrëveshje. Pra, Kosova vazhdimisht do të jetë në dialog me Serbinë dhe këtë do ta konsiderojë si çështje të brendshme të vendit.

Dhe e dyta, po ashtu është thënë që njëri prej ministrave të Qeverisë ose ekzekutivit të Qeverisë së Kosovës do të jetë edhe Aleksandar Jablanoviqi, apo jo? Mbase kjo nuk është e vërtetë, por kështu është thënë. Më sa di unë dhe deri sot paradite, Aleksandar Jablanoviqi është deputet në Kuvendin e Serbisë. Tash, ne do ta kemi një ministër, i cili njëkohësisht është deputet në Kuvendin e Serbisë.

A mund të ma thotë dikush prej juve, se ku do ta ketë lojalitetin ky person, a në Kuvendin e Serbisë, apo në Qeverinë e Republikës së Kosovës? Apo, ju si qeveri mendoni që këto dy çështje nuk janë përjashtuese njëra me tjetrën, pra mendoni se këto janë një dhe e vetmja gjë?

Dhe, unë po ju them që kjo nuk është një dhe e vetmja gjë. Pra, sikur me dialogun, sikur me këtë person, që natyrisht simbolizon një situatë politike, në të cilën ndodhemi, po tregohet që Qeveria e Republikës së Kosovës, ajo që po e kërkon votën e deputetëve, është një qeveri e cila Serbinë as nuk e konsideron si çështje të jashtme, sepse me të do të merret një ministër i veçantë e jo ministri për Punë të Jashtme dhe në anën tjetër, e konsideron pushtetin e Serbisë si legjitim për të qel pushtet edhe në Kosovë, nëpërmjet Listës serbe e nëpërmjet veçanërisht Aleksandar Jablanoviqit, si kryetar i kësaj Listës

serbe dhe njëkohësisht si anëtar i Partisë Progresive, që quhet atje në Serbi në Kuvendin e Republikës së Serbisë.

Po, desha t'i ngre edhe nja dy tri çështje edhe sa i përket kësaj marrëveshjes politike, që e kanë arritur dy subjekte, që është aktualisht dokumenti i vetëm që është i nënshkruar nga dy kryetarët e dy subjekteve ose e dy partnerëve të koalicionit.

Aty shihet, që në fakt ose ata që e kanë përkthyer dokumentin nuk marrin vesh fare, se çfarë ndodh në Kosovë, ose ata që e kanë shkruar dokumentin nuk marrin vesh se çfarë ndodh në Kosovë.

Po, cilado qoftë e vërteta, neve na është prezantuar një dokument përmes medieve, i cili në disa pika është jashtëzakonisht skandaloz. Për shembull, thuhet e këtu tregohet kjo mungesa e dijes, qoftë ose mungesa e saktësisë në përkthim, në pikën 7 thuhet, që PDK dhe LDK pajtohen se ndarja e ministrive dhe pozitave të tjera udhëheqëse në nivelin qendror do të bëhet në mënyrë të barabartë, sipas ligjit. Sipas cilit ligj ose cili ligj e rregullon ndarjen e dikastereve në një koalicion qeverisës në Kosovë? Unë nuk di që ka një ligj të tillë në Kosovë, mbase edhe ka, po ju kisha ftuar që të na tregoni se cili është ai ligj, që të shohim a ju keni përmbajtur përnjëmend sanksioneve ligjore për këtë çështje.

Çështja e dytë pastaj, që shihet në këtë dokument, në këtë marrëveshje, thuhet që ministrat e Kabinetit Qeveritar do të jenë përgjegjës për zhvillimin... me qëllim të përmbushjes së programit qeveritar dhe njëkohësisht, pra është vazhdim i fjalisë, do të jenë persona me integritet profesional dhe moral.

Unë këtu e kisha qitur pyetjen, cili është ai komision që ka vlerësuar integritetin moral dhe profesional të personave në Qeveri? Pra, kush, cili është ai komision që ia ka dhënë dritën e gjelbër, ta zëmë Hashim Thaçit për të qenë ministër në këtë qeveri? Në bazë të cilit integritet profesional dhe në bazë të cilit integritet moral ky njeri do të jetë ministër në qeverinë që po krijohet në Kosovë? Ose, ta zëmë, Aleksandar Jablanoviçi, ta përmendi prapë, i cili siç e thashë pra është deputet në Serbi, ose ta zëmë, që është përmendur Ferid Agani, i cili do të jetë po ashtu ministër në këtë qeveri, ose të paktën është raportuar si i tillë dhe i cili tash së fundi ishte ministër i një skandali jashtëzakonisht të tmerrshëm edhe korruptiv, po edhe në dëm të sigurisë dhe shëndetit të qytetarëve.

Pra, kush ka qenë ai komision që i ka vlerësuar ato, apo komisioni është përberë nga dy persona, nga dy nënshkruesit e marrëveshjes: Hashim Thaçi dhe Isa Mustafa, e atëherë pyetja është, po kush ka qenë komisioni që e ka vlerësuar integritetin profesional dhe moral të këtyre dy personave, që janë anëtarë të këtij komisioni?

Pra, këtu tregohet që në fakt, janë hedhur një grumbull fjalësh vetëm e vetëm sa për të thënë që kemi bërë një marrëveshje, ku në fakt marrëveshja, ose e vetmja marrëveshje që është bërë, është pika 6 ku janë ndarë postet, në të cilat janë ndarë dhe postet edhe me emra.

Mungesa e sinjeritetit edhe në raport me njëri-tjetrin, po edhe në raport natyrisht pastaj me Kuvendin dhe në përgjithësi me jetën politike, ekonomike e shoqërore të vendit, është shprehur disa herë edhe përmes medieve pas arritjes së marrëveshjes për koalicion. Pra, është shprehur përmes deklaratave të vetë anëtarëve dhe zyrtarëve të këtyre dy partive, kur për një kohë të gjatë deklarorin, se nuk do të bashkëpunonin në asnjë mënyrë me njëra- tjetrën, madje siç e përmendi edhe zoti Konjufca, ku është thënë që katastrofë për vendin do të ishte një bashkëpunim i tillë, nga zyrtarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, jo vetëm zoti Ismet Beqiri por edhe të tjerë, kur kanë folur për këtë punë. Dhe, kjo tregon se çfarë niveli të ulët të sinjeritetit kanë këta njerëz dhe kjo qeveri që po përbëhet karshi një bashkëpunimi, të cilin e kishin mbajtur fshehur dhe e nxorën para dy javëve.

Por, po ashtu është thënë që nga zyrtarët e PDK-së, qoftë nëpërmjet gazetarëve që i ndërsejnë, qoftë përmes punës së tyre në terren, gjatë tërë kohës e akuzonin Lëvizjen “Vetëvendosje”, pra po them gjatë tërë kohës, prej marrëveshjes së 10 shtatorit me Bllokun VLAN, se po takohemi dhe po bëjmë marrëveshje me Isa Mustafën, kështu na thuhej, i cili ka qenë ministër i Rrahman Morinës.

Ne, për t’ju kujtuar edhe një herë, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nuk e kemi votuar më 17 korrik atëherë të propozuarin Isa Mustafën për kryetar të Kuvendit, ne kemi abstenuar edhe atëherë, për shkak se s’kemi pasur marrëveshje për një çështje të tillë.

Ndërkohë, që tash ju që neve na akuzonit se po bashkëpunojmë me një ish ministër të Rrahman Morinës, ju po e bëni të njëjtin kryeministër. Pra, a keni ndryshuar ju, a paska ndryshuar ky? Sipas fjalëve që ju i keni thënë, po them, se nuk po aludoj në asgjë tjetër.

Ndërkohë, që natyrisht, edhe nga akuzat nga LDK-ja për Partinë Demokratike të Kosovës, kanë qenë edhe të shumëllojshme edhe nganjëherë tepër edhe të vrazhda dhe të tilla pushuan së qeni në momentin kur u arrit marrëveshja dy javë më parë për ndarje të pushtetit.

Natyrisht, që Lëvizja “Vetëvendosje” do ta kundërshtojë këtë qeveri jo vetëm me votën e saj në Kuvend sot, por do ta kundërshtojë vazhdimisht këtë qeveri, në mënyrë që jeta e kësaj qeverie të jetë sa më e vështirë, sa kohë që do të jenë në postet e tyre dhe sa më e shkurtër në institucionet e vendit dhe kjo, për të mirën e vendit, për ta shpëtuar atë pak Kosovë, që mund të jetë nga pas qeverisjes së kësaj qeverie.

Pra, natyrisht që shumë qytetarë të Kosovës pyeten sot, se a ka ku shkon më keq dhe unë mendoj se natyrisht që ka ku shkon më keq! Sot është përnjëmend shumë keq, mirëpo nesër do të jetë edhe më keq kur të fillojë kjo qeveri të punojë! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Tërmkolli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar pjesëmarrës,

Më vjen keq që nuk është kryetari, sa u zgjodh tash i Kuvendit, nuk është as kryeministri Thaçi, do të doja të jetë këtu, jo se më ka marrë fort malli t'i shoh, po sepse është mirë t'i dëgjojë disa gjëra që duhet t'i dëgjojnë.

Ka shtatë vjet që sidomos deputetë të LDK-së, ndoshta jo pjesa më e madhe e tyre, po sigurisht Sabri Hamiti po, e mban mend që para shtatë vjetësh këtu e kam pas paraqitur një çështje dhe të njëjtën çështje dua ta përsëris edhe njëherë. Ajo çështje ka të bëjë me faktin se atëherë e shtrova çështjen, si u bë që të bëhet koalicion mes PDK-së dhe LDK-së pa u sqaruar disa gjëra. Ndonjëherë, koalicionet edhe mund të bëhen, nganjëherë edhe të panatyrshme, të natyrshme, qysh të donë ta marrin, po si u bë pa i sqaruar disa gjëra. Dhe, ato gjëra, ai sqarim sot është më se i domosdoshëm dhe kjo pyetje është edhe më aktuale edhe sot kur kryetar Parlamenti u zgjodh një person, i cili ka qenë në krye të një organizate të fshehtë që është quajtur SHIK.

Atëherë, pata parashtruar pyetjen dhe po e parashtroj edhe sot, a e dinë këta njerëz dhe duke qenë pjesëtarë të shërbimeve të fshehta, ne e dimë shumë mirë që do të duhej ta dimë se si funksionojnë dhe punojnë ato dhe sa kanë informacione dhe njohuri.

Andaj, unë e shtroj pyetjen se kush i vrau njerëzit politikë? Kush e vrau Enver Malokun, kush e vrau Xhemajl Mustafën, kush e vrau Shaban Manajn, kush e vrau Ismet Rracin, kush e vrau Smajl Hajdarajn, kush e vrau Ukë Bytyçin, kush e vrau Tahir Zemajn, kush e vrau Bardhyl Ajetin? Kush i vrau edhe shumë e shumë të tjerë? Ende nuk është dhënë përgjigja në këtë pyetje, kush i ka vra. Dhe prapë ky koalicion vazhdon edhe pa i marrë këto përgjigje.

E përmendëm këtu disa herë emrin e ambasadores Jekobson. E falënderuan, e falënderuan sa s'mundën më. Shumë mirë është që e falënderuan dhe që e përshëndetën, mirëpo harruan një gjë, kanë harruar ta pyesin se në vendin e saj dhe në vendin e vlerave perëndimore, të vendeve perëndimore: a ka mundësi dhe si ka mundësi një njeri që udhëheq një organizatë të fshehtë të bëhet kryetar i një institucioni të lartë publik? Në këto vende perëndimore, kjo nuk ndodh.

Ka pasur PDK-ja njerëz të cilët ka mund t'i kandidojë, pse nuk e ka bërë, është punë e tyre, por në vendet perëndimore kjo nuk ndodh. Kjo nuk ka ndodhur kurrë.

Paramendoni Xhorxh Teneti, shef i CIA-s, po të bëhej president, ose kongresmen ose senator amerikan, këtë nuk e lejon Amerika, këtë nuk e lejojnë vendet perëndimore, shefat e shërbimeve të fshehta që i kanë, por te ne lejohen, sepse te ne shantazhi është ai që e udhëheq shtetin, krimi është ai që e udhëheq shtetin, korrupsioni është ai që e udhëheq shtetin. Kështu nuk po shkruhet mbarë.

E thanë edhe vetë, e tha vetë kryetari Zoti më ndihmoftë! Ai e diti shumë mirë se ia diti hallin veti. Ishalla e ndihmon Zoti por është pak vështirë me të ndihmuar edhe zoti kur nuk ia qëllon edhe vetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të dashur kolegë deputetë,

Po më vjen keq se disa prej zyrtarëve të PDK-së, do të LDK-së, disa që janë këtu dhe ata që janë jashtë ndoshta hala janë në ankth për të dëgjuar a po u përmendet emri për ndonjë nga pozitat ministore apo të zëvendësministrave në këtë farë aksham pazari se si duket hala është duke vazhduar për të shijuar një copë torte nga ai koalicioni i tortave i cili është përmendur shumë pasi që koalicioni i shpresës u shua tashmë.

Me gjithë këto probleme duke përfshirë edhe problemet për ekzistencë në Kosovë në prezantimin e tij i nominuari për kryeministër e dha një theks të veçantë i cili mua më bëri përshtypje për zhvillimin e baletit të valleve e këngëve të cilat me siguri ka për t' i luajt Ansambli "Shota".

Si duket, kjo Qeveri do ta bëjë Kosovën Bollivud apo Holloivud sa që edhe Xhorxh Kluni do t'ia ketë lakmi për të ardhur të luajë filma në Kosovë.

E përmendet sundimin e ligjit dhe ndihmën që do t'ua afrojë kjo qeveri gjyqësorit. Më duket, zotëri Mustafa nuk e paska konsultuar kolegen e vet Vjosa Osmani e cila jam e sigurt se do t'i shpjegonte se gjyqësori është i pavarur nga Ekzekutivi.

Të paktën kështu funksionon në demokraci, se gjyqësori është ai që merret me dosjet, i shqyrton ato dhe i vë të akuzuarit para drejtësisë. Këtë nuk mund ta bëjë ekzekutivi.

Disa nga kolegët e LDK-së, në bisedat që i kemi pasur më herët, patën deklaruar, bile kanë bërë edhe be se" kanë me i pre duart e nuk kanë me votua për një koalicion me PDK-në".

Kolegë të nderuar: "mos i preni duart se sistemi i shëndetësisë është shumë i dobët dhe keni me pas vështirë me gjet shërim" por ajo çka mund të bëni është të mos e ngrini atë kur t'ju kërkohet të votoni për qeverinë.

Po ashtu, në fjalimin e tij zotëri Mustafa foli edhe për lirinë e shprehjes, por në një marrëveshje që ata kanë nënshkruar me PDK-në, në pikën 13 dhe 14 të saj i mohohet deputetëve të zgjedhur me votën e lirë që ata të guxojnë e të votojnë ndonjë gjë e cila nuk e ka marrë paraprakisht miratimin nga qeveria, kështu që nuk e di për çfarë lirie të shprehjes apo të veprimit po bëhet fjalë.

Dhe një këshillë e vogël për kryeministrin i cili do të zgjidhet. Ju lutem shkoni edhe vizitoni Stacionin e autobusit, qoftë në Prishtinë apo në cilindo qytet tjetër dhe pyesni nëse Ansambli "Shota" do ua bënte më të lehtë atyre ikjen me autobusë që ata në vazhdimësi po bartin për Hungari e vende tjera.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Limaj, le të përgatitet zonja Kadrijaj.

FATMIR LIMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar kolegë deputetë,

Mysafirë,

Kandidati për kryeministër, mandatar i tha që programin qeveritar do ta bie në ditën në vazhdim, pas miratimit të qeverisë dhe sigurisht do të kemi kohë të mjaftueshme të bëjmë analizë dhe të flasim për programin i cili do të qeverisë vendin.

Ajo që unë do të them disa fjalë, është do të përqendrohem në dy pika më tepër. E para, për t'ju kërkuar tani shumicës, që kujdes, kujdes nga numrat. Pasja e numrave të nderuar kolegë nuk do të thotë që keni çdo gjë në dorë. Sjellja e juaj, bile sa më shumë numra, sjellja e juaj duhet të jetë shumë më e përgjegjshme, e kujdesshme për të mos rrezikuar transparencën, mundësinë e debatit, dialogut, diskutimeve dhe funksionimit ashtu siç duhet edhe Parlamenti edhe institucionet tjera.

Sjellja e shumicës, do të shikohet dhe duhet të ketë kujdes nga ajo që unë veç e kama thënë një ditë më herët, arroganca e numrave, se pastaj arroganca e numrave shndërrohet në arrogancë të pushtetit dhe kjo pastaj krijon situata të tjera.

Ne si opozitë, e duhet ta keni të qartë që opozita në vend nuk është thjeshtë vetëm numri, opozita do ta ketë zërin e fuqishëm aty ku është duke koordinuar aktivitetet e veta dhe jo gjithëherë numri është përcaktues, përcaktues janë temat, qëndrimi, rruga dhe mënyra e të bërit opozitë dhe besoj që në këtë Parlament ka njerëz me përvojë të mjaftueshme të cilët kanë kaluar në fazat e opozitës dhe do të dinë ta bëjnë opozitën ashtu siç duhet.

Marrëveshja e koalicionit, secili subjekt politik ka të drejtë të marrë vendime dhe qëndrime politike vetë. Se a ka qenë i drejtë a s'ka qenë i drejtë ajo marrëveshje politike ose ky koalicion, më së miri dhe vetëm atyre u takojnë ta gjykojnë ata që kanë votuar. Votuesit e tyre janë ata që e gjykojnë a ka qenë i drejtë apo jo koalicioni dhe ne këtu nuk lëshohemi në këtë çështje, sepse është ekskluzivisht e drejtë e secilit subjekt politik.

Pastaj koalicioni në shërbim të qeverisjes së vendit, atëherë ne e themi fjalën tonë. Nuk ka asnjë dilemë për çdo qytetar të këtij vendi që ky ishte një koalicion i zorit, i domosdoshëm ose sido që ta quajmë.

E merre me mend një koalicion të zorit se çfarë qeverisje mund të ketë. Sot si kurrë më parë vendi ka nevojë për mbledhjen e të gjitha energjive pozitive të fuqishme, profesionale, njerëzore për ta nxjerrë vendin nga një kaos, nga ky kaos që është sot, kaos në shëndetësi, kaos në arsim, kaos në administratë, kaos në drejtësi, thjeshtë vendi, Kosova sot me financa që ka, me buxhetin që e ka, është në gjendje para bankrorit. Dhe për të kaluar, për ta tejkaluar këtë situatë do të duhej të kishte një koalicion i ndryshimit, një koalicion me energji pozitive që do ta ndryshonte qasjen ndaj shtetit, ndaj këtyre institucioneve. Kjo është ajo që kanë pritur qytetarët e vendit tonë.

Fatkeqësisht kjo s'ka ndodhur, mbetet të shihet. Pa dyshim që ka emra të rinj, të cilët do të donin me energji të reja të futen në një qeverisje të re për të ofruar eksperiencën e tyre, dëshirën për ta ndryshuar, po ata emra të ri që do të futen në këtë qeveri, unë ju them se do ta kenë jashtëzakonisht të vështirë, për të mos thënë të pamundur ta ndryshojnë

klimën, sepse klima do të jetë ajo që ka qenë deri më tani, fatkeqësisht edhe përkundër vullnetit të tyre do të jetë shumë vështirë për ta ndryshuar gjendjen.

Shpresoj që do ta ndryshojnë, sepse çdo ndryshim pozitiv do të ishte i mirë për të gjithë ne. Por çdo gjë që do të dështojë duhet ta kenë të qartë se tani e tutje do të marrin koston e përgjegjësisë për mosrealizimin e objektivave të parapara.

Gjithashtu dua të them që ju përveç që e keni zhgënjyer dhe befasuar elektoratet tuaja, thënë të drejtën, e keni befasuar, t'ju them të drejtën edhe neve na i keni tejkaluar parashikimet, se s'kam besuar disa rokada që po shoh kanë ndodhur, bash mendja s'ma ka marrë. Krejt kam menduar, por se e lëshon Hashimi kryeministrit kështu e ia jep Profës s'ma ka marrë mendja.

Për këtë, urime! S'di çka të them , me i marrë votat e Partisë Demokratike, me dhënë kryeministrin e aq më tepër tash edhe me t'u bërë ministër... ma kanë tejkaluar parashikimin tim, të thënë të drejtën. As nuk kanë dilemë që ju dy palët i keni befasuar dhe zhgënjyer votuesit tuaj, por në fund të fundit janë votuesit që e gjykojnë, sido që të jetë.

Ne do të vazhdojmë opozitë dhe ju siguroj se ne do të jemi opozitë konstruktive për aq sa është pushteti konstruktiv dhe jo arrogant. Ju ftoj mos të jeni arrogantë, mos të ndikoheni nga pesha e numrit, jo gjithherë numri kryen punët. Punoni e veproni për vendin, të them punoni veproni për vendin ishalla sikur që thanë do që iu kanë lutur Zotit sot shumë këtu dhe jo rastësisht, por ajo që ka nisur nuk është ndryshim, është vazhdim. Dhe vazhdim ajo që ne e kemi thënë: detyra mbi detyrë është çkapja e shtetit. Ata që kanë ndihmuar dhe po ndihmojnë, po legjitimojnë, e unë dua të them, mos harroni me segmente të komuniteti ndërkombëtar njerëzit deri tash e kanë shtruar rrugën për të ardhur këtu ku janë sot, si të them duke shkatërruar, duke anatemuar, duke përndjekur për të krijuar hapësira për veti.

Shpresoj se edhe komuniteti ndërkombëtar tani e tutje, ai element, ta shikojë mirë e të reflektojë se mos t'i mbyllë sytë e ta amnistojë të keqen dhe t'i ndjekë ata të cilët punojnë për vendin e tyre. Shpresoj se kjo do të ndodhë dhe kështu do të ecet përpara.

Po e përmbylli këtë fjalë timen duke thënë që mos iu gjuani Ismet Beqirit. S'është vetëm Ismeti që ka thënë kështu. Se një e dy, ju zotit Beqiri. Ju ka ra në mend ose ju ka mbetur fjala e fundit ose kujtimi i fundit për Ismetin se jeni duke e parë në KTV veç Ismetin, por janë me qindra ashtu që kanë thënë sikur Ismeti. Tash e tutje të shohim se si do të shkojë realizimi i objektivave për të cilat janë thanë, nuk do të jetë e lehtë, do të jetë e vështirë. Si do që të jetë koston për veprime dhe mosveprime, koston politike e merr secili vetë.

Unë uroj dhe dëshiroj sepse nuk besoj se ka njeri në këtë vend që nuk do të donte ta kishte një qeveri të suksesshme për vendin e tij.

Unë dua dhe dëshiroj që të kemi një qeveri të suksesshme për vendin tim , sepse çdo gjë, çdo sukses për qeverinë do të ishte e mirë për qytetarët e Kosovës. Ajo që po nis, zoti ju ndihmoftë! Ishalla!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Deputetë të nderuar,

Qytetarë të Kosovës,

Koalicioni PDK-LDK është koalicion i paarsyeshëm, i papritur apo edhe i detyruar, koalicion jo parimor.

Sot u bënë bashkë SHIK-u, PDK-ja dhe LDK-ja, koalicioni që do t'ia sjellë të keqen këtij vendi. Ishte ajo LDK-ja që gjatë mandatit të kaluar, qoftë gjatë debateve ishin kategorikë në luftën kundër SHIK-ut dhe kundër qeverisë Thaçi. Ishit ju LDK që mashtruat qytetarët dhe grumbulluat vota se ju jeni që do të sjellni dyshime duke e larguar Thaçin nga Qeveria.

Sot, në momentin e votimit të kryeparlamentarit, Kadri Veseli, ju votuat kryeparlamentarin, si do të arsyetohej para elektoratit? E ju deputetë të PDK-së që jeni të shumtë nga strukturat e SHIK-ut, do të jetë shumë interesant në momentin që do ta votoni Qeverinë e Isa Mustafës.

Po, çjerrjet e zyrtarëve të LDK-së se kurrë nuk bëjnë koalicion me PDK-në paskan qenë pjesë e fushatës politike. Pra, ju mundësuat dhe legjitimuat bashkimin e dy të këqijave, ju e krijuat Qeverinë Thaçi 3. Se politika s'ka moral na e argumentuat sot ju, zyrtarë të LDK-së.

E sa i përket programit, ai është mirë i ilustruar dhe i fantazuar. Qytetarë, mos pritni se diçka e mirë do të ndodhë në këtë mandat.

Qytetarë të nderuar,

Tani do të jemi bashkë në luftimin e kësaj të keqeje që e ka kapluar Kosovën. Zoti na ndihmoftë në rrugëtimin e përbashkët!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ambasadorë të vendeve të ndryshme,

E nderuara zonja Lunaçek,

Të nderuar kolegë deputete dhe deputetë,

Përfaqësues të mediejeve,

Fillimisht dua të uroj për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit dhe formimin e institucioneve si derë hyrëse për formimin e Qeverisë, edhe pse vetë personalisht kam votuar kundër, ngase qëndrimet e mia tashmë vetëm i dini. Jam deklaruar kundër, për faktin se nuk jam as pjesë e grupit parlamentar. Edhe në të ardhmen do të veproj si deputet i pavarur.

Por, ajo çka më intrigoi dhe më shtyri të flas para juve sonte, pa dashur të ju marrë shumë nga koha juaj e çmuar, është që të flas sadopak, qoftë për koalicionin e tashëm, qoftë për të kaluarën, ngase për të ardhmen është hipotetike edhe paragjyquese të flasim se si do të jetë.

Është shumë e padrejtë të akuzohet drejtpërdrejt dhe sonte këtu i mandatarin për kryeministër, deputeti Isa Mustafa, kryetar i Lidhjes Demokratike, ngase ende nuk e dimë se si do të veprojë. Unë e di pse vijnë edhe ato kritika ndaj tij, po në anën tjetër është shumë e padrejtë të kritikohet edhe Partia Demokratike për gjendjen aktuale në Kosovë, për faktin se nuk është vetëm ajo përgjegjëse për gjendjen në Kosovë. Është përgjegjës tërë spektri politik për 15 vjet të pasluftës që e kanë sjellë Kosovën në këtë gjendje.

Populli i Kosovës nuk e meriton një gjendje të tillë. Populli i Kosovës meriton shumë, ngase ka vuajtur shumë në raport me të gjithë popuj tjerë të Ballkanit e të Evropës, në përgjithësi.

Është shumë e rëndë të flitet për ne si shtet i ri me 2 milionë banorë. Po thuhet edhe në raportet ndërkombëtare, e në veçanti në Raportin e Progresit që Kosova është një vend me shkallë të lartë të krimit të organizuar dhe me shkallë të lartë të korrupsionit.

15 vjet pas luftës është mbjellë ky korrupsion, është mbjell ky krim i organizuar. Kemi vrasje të pazbuluara ende. Kemi ende krim të organizuar, kemi haraç, kemi fajde në të gjitha trevat e Kosovës. Prandaj, vetë sundimi i krimit të organizuar e ka krijuar një njollë jo të mirë për Kosovën. Të mos të harrojmë, për 15 vjet pas luftës asnjë zyrtar i lartë i Qeverisë së Kosovës, qoftë kryeministër, qoftë ministër, nuk është i burgosur për korrupsion. A mendoni se të gjithë janë të pastër? Nuk po dua të paragjykoj se të gjithë i kanë duart e përljera, por unë mendoj që këtu ka diçka, e fatkeqësisht sistemi i drejtësisë në Kosovë nuk ka qenë në gjendje ta luftojë një gjë të tillë.

Të mos harrojmë se në vendet e rajonit, pa dashur të përmend emra, kemi kryeministra dhe ministra të cilët janë arrestuar dhe janë burgosur për korrupsion. Atëherë, nëse na del kjo dhe e analizojmë, e shohim që Kosova nuk ka problem as me sundimin e ligjit, as me problemin e korrupsionit, por fatkeqësisht është e kundërta.

Kemi numër të madh dhe shkallë të lartë të korrupsionit në çdo institucion shtetërorë, publik dhe privat të Kosovës. Fatkeqësisht, nëse e shikoni vetëm gjendjen - statusin e zyrtarëve qeveritarë, gjatë 15 vjetëve të pasluftës do të shikoni se si ata kanë punuar më shumë për vetveten se për popullin e tyre.

Nëse i shkon vetëm veturat e ministrave, të gjithë të kaluarit, nuk po flas me emra të përveçëm, as të kësaj apo asaj qeverie, dhe luksin si ka jetuar një ministër, do ta shihni se Kosova nuk është Kosovë, por është Monako. Por, fatkeqësisht 40% e popullsisë jeton në varfëri me 17% ekstreme.

Nuk është kritika vetëm për ministrat. Kritika është për deputetët, se fatkeqësisht jemi të vetmit deputetë në rajon që e kemi pagën tetë fish më të madhe se paga mesatare në

Kosovë, përderisa në vendet tjera të rajonit e kanë dy-tre fish. Prandaj, ne duhet t'ia bëjmë një vetëkritikë vetvetes, t'ua bëjmë një vetëkritikë të gjithë të tjerëve, pastaj të ulemi dhe të punojmë për të ardhmen.

Unë dëshiroj t'i falënderoj këtu edhe përfaqësuesit e vendeve ndërkombëtare, ambasadorët e nderuar. Vendet e tyre pa dyshim që e kanë dhënë një kontribut të madh në lirinë dhe pavarësinë e Kosovës dhe vazhdojnë të japin ende kontribut. Por, unë jam plotësisht i bindur që as këta nuk janë të kënaqur me lidërshtipin e këtyre 15 vjetëve në Kosovë, meqë kanë qenë këtu të pranishëm. Këta duhet të dinë dhe unë jua bëj publikisht unë, të jem i drejtpërdrejtë dhe i sinqertë me ta se fatkeqësisht, të nderuar partnerë ndërkombëtarë, për 15 vjet të pasluftës nuk keni pasur lidërshtip të mirëfilltë dhe parimor të Kosovës që ju ka mbështetur dhe ju ka respektuar.

Më vjen keq që e them këtë, të nderuar partnerë ndërkombëtarë, por lidërshtipi i Kosovës, pa dallim, shumica në përgjithësi, ju ka shikuar ju si mjet për ardhje në pushtetin e tyre. Prandaj, ju si partnerë ndërkombëtarë, nuk guxoni të lejoni në asnjë moment që të zbehet kjo simpati e qytetarëve të Kosovës ndaj jush, nga njerëz të cilët vërtet nuk e meritojnë një gjë të tillë.

Unë ndoshta pas po flas në vija të trasha, por për gjysmë minute do ta shpjegoj edhe në vija të holla se si po ndodh kjo. Ju e dini që Kosova i ka caktuar prioritetet të saj. Kosova e ka zgjedhur rrugën e saj drejt integritit në Bashkimin Evropian dhe pa dyshim harmonizimi i ligjeve, legjislacioni i Kosovës, duhet të njihet me legjislacionin e Bashkimin Evropian. Por, mos harroni, po e shfrytëzoj rastin ta përshtendes këtu në veçanti përsëri zonjën Lunaçek, e cila është mjaft e zëshme në çështjen e të drejtave të njeriut, se Kosova vazhdon të jetë ... vetëm në Ballkan dhe në Bashkimin Evropian, ku shkelen të drejtat fundamentale të njeriut.

Vajzat e Kosovës nuk lejohen të shkollohen në shkollat fillore dhe të mesme për shkak të bindjeve të tyre fetare, për shkak të mbulesës. Një gjë të tillë e lejon Kushtetuta e Kosovës, por është udhëzimi administrativ i një ministri të kaluar, i cili i ka ndaluar, i ka privuar këto vajza të shkollohen. Kjo është shkelje e rëndë. Unë i kam vizuar shumë vende të Bashkimin Evropian dhe në asnjë vend vajzat nuk privohen për shkak të mbulesës. Bashkimi Evropian i respekton në plotësi të drejtat e qytetarëve të vet pa dallim feje dhe kombi.

Prandaj, edhe ne qytetarë duhet të jemi koshientë dhe të veprojmë konform, asaj që desha ta sqaroj, ta ndërliidhi me punën dhe politikën që ka bërë lidërshtipi është se: ndalimi i vajzave, ndalimi i shkollimit të vajzave nga ministri i caktuar, i udhëzim cili vazhdon të jetë prapë në fuqi, është bërë për shkak të bindjeve të tij personale.

Ky lidërshtip shumë gjëra i bën për shkak të bindjeve personale. Por, kur vjen koha e fushatës e thotë 'këtë po e kërkojnë ndërkombëtarët'. Te populli, fajin ua lë ndërkombëtarëve, ndërsa veprat e tij bëhen për shkak të qëllimeve të tij.

Prandaj, nuk guxojmë të lejojmë që qytetarët e Kosovës ta humbin simpatinë dhe mbështetjen që e kanë aktualisht, qoftë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qoftë për Bashkimin Evropian, ngase edhe Shtetet e Bashkuara, edhe Bashkimi Evropian, në plotësi respektohen të drejtat e shkollimit dhe të punësimit të vajzave me mbulesë.

Kosova është i vetmi vend që është i privuar nga mësimi fetar, përderisa në shumë vende të Bashkimit Evropian është obligativ dhe diku joobligativ. Ne ende nuk e kemi një gjë të tillë. Prandaj, këto janë mjaft të rënda për neve si shtet që synojnë të jemi pjesë e Bashkimit Evropian.

Dhe për fund, pa dashur ta zgjas shumë, unë kërkoj nga Qeveria e ardhshme që do të votohet këtu në Kuvendin e Kosovës, prapë po them nuk do ta votoj për faktin se jam i tradhtuar, jo në interesa personale, por në parime dhe në marrëveshje, prandaj e kam të vështirë ta votoj këtë koalicion, por mirëpres nga kryeministri dhe Qeveria që së paku në këtë mandat dhe tutje në të ardhmen të punojnë për qytetarët e Kosovës, se populli i saj meriton më shumë. Me mijëra fëmijë i kemi në gjendje të rëndë shëndetësore, të cilët nuk kanë mundësi të shërohen, ndërsa ministrat e ndryshëm kanë vetëm vetura prej mijëra euro. Kemi mbi 40% të papunë, kemi shkallë të rëndë të papunësisë dhe shkallë të rëndë të krimit të organizuar.

Prandaj, nga kryeministri pres që kësaj radhe së paku, si dhe ministrat, Kabineti qeveritar, të mendojnë për popullin, e jo vetëm për vete. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj e ka fjalën. E ka tërhequr. Atëherë zonja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Të nderuar deputetë,

Mysafirë, të gjithë ju të pranishëm,

Sot të gjithë ne ishim dëshmitarë të një skene, që më së paku e kemi pritur, pas sjelljeve të pandalshme dhe të papërgjegjshme për gati gjashtë muaj me radhë të bashkautorëve të këtij koalicioni, kryesueses së pushtuar verbërisht nga subjekti i saj, dhe Presidentes absolutisht kukull dhe të papërgjegjshme. Sot të gjithë ne pamë dhe u bindëm se në këtë shtet, ndër më të varfrit në botë dhe në Evropë, çdo gjë është e mundur.

Krijimi i Qeverisë së re me këtë përbërje e dëshmon më së miri papërgjegjshmërinë e lidërshit të këtyre dy subjekteve, pra të PDK-së dhe LDK-së.

Sot, për fat të keq, u vendos që krimi dhe e liga të rrugëtojnë së bashku. Kjo nuk shpjegohet ndryshe, nëse i thërrasim mbamendjes sonë shumë të afërt, të vjedhësh vrer mbi 7 vjet me radhë në mënyrë të drejtpërdrejtë për kapjen që iu bë shtetit tonë dhe për krimin e organizuar gjatë gjithë kësaj kohe dhe brenda natës të shkelesh mbi të gjitha këto thirrje e parime, duke iu bërë krahë të keqes më të madhe. Kjo vërtet nuk do koment!

A ka njeri normal në këtë vend që pas gjithë këtyre gënjeshtrave të këtij lidërshi do të vazhdojë ta besojë kryeministrin dhe zëvendëskryeministrin e ri. Nuk besoj, sepse një

pjesë shumë e madhe e tyre tashmë veç e kanë braktisur Kosovën, qindra të tjerë janë në rrugë të pashpresë për të nesërmen e tyre dhe mijëra të tjerë, që në mundësinë e parë ëndërrojnë ta lëshojnë vatrën dhe shtëpinë e tyre për një copë bukë. Kjo është një fatkeqësi e madhe me pasoja absolutisht të pakthyeshme për qytetarët.

Ky koalicion është joparimor, pikëpamjet e tyre nuk janë as konceptuale. Këto janë thjesht bashkëpunime të liga për pushtet e kundër shtetit të Kosovës.

A nuk ka të drejtë që sot çdo qytetar i vendit tonë të ndihet i zhgënjyer në injorancën e të tmerrshme të kryeministrit të ri, i cili vetëm pak ditë më parë zotohej që kurrë nuk do të lejojë të bëhej pjesë e një krimi të paparë në ish-Qeverinë dhe e kapjes makabre të shtetit edhe të gjitha institucioneve të saj. A ka turp më të madh, a ka ironi më të madhe si kjo që sot sapo e dëgjuam nga kryeministri, i ri i cili brenda natës ulet pa fije turpi në sofrën e krimit, të korrupsionit dhe të faqes së zezë, që për fat të keq do të vazhdojë ta ngulfasë ardhmërinë e qytetarëve të këtij vendi.

I njëjti, vetëm para disa javësh deklaronte çdo ditë se më shumë se 70% e qytetarëve të vendit nuk e dëshirojnë qeverisjen PDK. Ndërsa sot ka vendosur t'i prijë asaj, së paku formalisht.

Si mund t'i besohet këtij njeriu që brenda natës shkel çdo normë njerëzore, çdo parim intelektual për një qëllim të caktuar - akomodimin e vetes së tij në pozicionin aq të dëshiruar, madje-madje edhe pa pëlqimin dhe dëshirën fundamentale të bashkëpartiakëve të tij, të votuesve të tyre.

Një gjë është e sigurt - perspektiva e ndritur e këtij vendi që sot do të jetë shumë e largët, e zymtë dhe e pashpresë për njerëzit e tij, sepse nuk ka si të ndodhë ndryshe, kur sot përfundimisht u bashkuan të këqijat më të mëdha, kur sot u kurorëzuan krimi i organizuar, korrupsioni, nepotizmi dhe liga e këtij vendi.

Sot u zgjodh kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, me votat e pakicës. Sot na u tha që e paska titullin doktor. Unë po e citoj ish-drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, zotin Jusuf Thaçi, i cili në një debat televiziv javën e kaluar tha 'doktor, besa edhe i mençur'. 'I mençuri doktor' nuk do të zgjidhej, sepse e pamë që nga grupi i LDK-së nuk e votuan, ose votuan kundër tij 1/3 e deputetëve. Prandaj, ju shkoftë mbarë, sepse të mbarë nuk ka në këtë vend!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Media, mysafirë, qytetarë,

Sot realisht e dëgjuam një recitim të bukur që e kemi dëgjuar shpesh nga zoti Mustafa, por ajo që është befasuese, në të njëjtën kohë edhe shqetësuese, është se si ne diskutojmë për një program për një të ardhme të një qeverie, kur s'e dimë cilët janë ministrat.

Në fakt, është një kombinim i panatyrshëm, u dëgjua shpesh nga kolegët e opozitës, e unë do të them edhe i çuditshëm. Pse i çuditshëm? Sepse, shpesh më ka rënë të dëgjoj nga LDK-ja, që thoshin për PDK-në janë “enveristë”, e këta të PDK-së për LDK-në “titistë”, dhe ky kombinim i çuditshëm nuk e shoh se do të jetë frytdhënës për të ardhmen e vendit dhe të qytetarëve, të cilët presin shumë.

Ne, si nga Isa Mustafa, gjithashtu edhe nga Hashim Thaçi, gjatë fushatës kemi dëgjuar shumë premtime. Në fakt, me emrat e përfulur si ministra të ardhshëm, unë nuk besoj se ato premtime do të realizohen, por thjesht do të vazhdojë avazi i vjetër i keq qeverisjes, i krimit dhe korrupsionit në Kosovë.

Fjalimi i Isës, e thashë, ishte një recitim i bukur, retorikë boshe, që e kemi dëgjuar shpeshherë. Kësaj radhe, ka qenë një dallim se është recituar me duar jashtë xhepave. Prandaj, unë po besoj se me këtë kombinim që e keni bërë i keni dhënë një goditje të rëndë perspektivës evropiane të Kosovës dhe së ardhmes të qytetarëve të Kosovës. Qytetarët e Kosovës kanë pritur shumë nga zgjedhjet e 8 qershorit dhe torturimi që ua ka bërë, veçanërisht LDK-ja për 5 muaj, duke qëndruar me Bllokun dhe rreth tij, dhe prapaskenat që janë luajtur, thjesht e kanë fundosur përfundimisht shpresën e së ardhmes të këtij vendi dhe jorastësisht edhe nga një koleg deputetë u përmend, me qindra të rinj çdo natë, ndoshta edhe në kohën kur ne po flasim këtu, janë duke e lëshuar këtë vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Deputetë,

Mysafirë,

Zonja e zotërinj,

Edhe një herë, si edhe kolegët e mi, e konfirmoj kundërshtimin tonë për atë çka u zhvillua dhe pritet të zhvillohet në seancën e sotme. Por, për atë çka pamë dhe dëgjuam, nuk më vjen keq që shumëkush duket se do t'i shuajë orekset e veta për pak pushtet, pavarësisht me çfarë çmimi. Po ashtu, nuk më vjen keq edhe nëse Qeveria e ardhshme do ta zbusë papunësinë duke i emëruar ministra, zëvendësministra e të tjerë në Kabinetin e vet, dhe uroj që këto të mos jenë punësimet e fundit në radhën e premtimeve të tyre. Por, ndonëse nuk më vjen keq për këtë, më vjen shumë keq për qytetarët dhe të ardhmen e Kosovës. Më vjen keq për fëmijët e këtij vendi se në çfarë shteti rrezikojnë të rriten.

Kolegët e mi me të drejtë kërkuar që sot ta debatojmë programin qeverisës dhe normalisht që ne do t'ju kishim kërkuar, sikur ju ta kishit, dhe kjo rezulton që ju nuk keni program qeverisës, prandaj ne po ju kursejmë që t'ju kërkojmë diçka që në të vërtetë nuk keni. Po ashtu, e dëgjuam fjalën që u quajt edhe rezyme e kandidatit, apo të dominuar për kryeministër. Ai e kërkoi besimin edhe të qytetarëve, edhe të deputetëve, kur njëkohësisht besojeni se as vetes nuk i besonte për atë çfarë fliste. Rezymeja e tij, pra e të nominuarit, ndryshonte prej asaj çfarë ai ka folur gjatë fushatës elektorale, nuk po them asgjë të re, po them diçka që u përsërit këtu, por le të përsëritet.

Ndryshoi komplet prej fjalëve të tij, prej thirrjeve të tij gjatë fushatës elektorale si kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, por nuk e di se në fjalën e ndryshuar apo të ridizajnuar, me skenar gjithsesi nga radhët e PDK-së, ai i paska harruar edhe vetë ato qëndrimet shumë pompoze, kur thoshte: “Kurrë me PDK-në!” dhe normalisht vjen rrjedhshëm pyetja për kolegët deputetë të Lidhjes Demokratike të Kosovës nëse e kanë harruar tash shtetin e kapur, a e kanë harruar tash shtetin kriminal të Thaçit? Kështu e quanin. A e kanë harruar këta sistemin e SHIK-ut? A e kanë harruar këta keqqeverisjen? Apo tash duan ë ta amnistojnë gjithë këtë krim, të cilin vetë e kanë denoncuar.

Por, një gjë që e vërejta unë, sot fjala e Isës si rezyme ishte shumë e ngjashme me programin qeverisës të Partisë Demokratike të Kosovës, sa për një moment mendova se mos Isa po e lexon fjalimin e Thaçit në fushatë dhe prita që brenda fjalimit të tij që Isa ta lexojë dhe të na e thotë edhe atë pjesën kur Thaçi e shante LDK-në dhe e quante Isën ‘Putin’.

Normalisht, nga kjo çfarë bëri Isa sot nuk e bëj përgjegjës gjithë elektoratin e LDK-së, në asnjë mënyrë, dhe po ashtu ne nuk ndihemi të tradhtuar nga ai, për shkak se edhe ashtu ne nuk i kishim dhënë ndonjë besim dhe nuk i kemi besuar. Nëse dikush është i tradhtuar janë pikërisht janë votuesit, të cilët e kanë votuar një program, të cilin ata tash nuk e kanë dëgjuar sot në këtë foltore në pjesën e rezymesë të kandidatit për kryeministër.

Por, ajo që besoj se ju kujtohet dhe është e freskët në mesin e shumë të tjerave, ajo kur Isa i mallkonte qytetarët pse nuk e votonin atë për kryetar të Prishtinës, ky mallkim më duket se rrezikon që mund t’i rikthehet atij, i cili kishte mallkuar dikur. Pra, nuk i marron Zoti qytetarët, por ata që i mallkojnë qytetarët.

Një gjë sot duhet t’ia çmoj Isës, për shkak se e vetmja gjë që duhet t’ia çmoj atij sot është turpi që ai ka manifestuar gjatë gjithë kohës, sepse ka ndenjur në karrigen e tij me kokën ulur dhe me fytyrën e tij pa muskuj. Fatmiri e tha dhe e quajti këtë koalicion si koalicion i zorit, dhe vetvetiu m’u kujtua një thënie apo proverb popullor, që zori i bënë bashkë ujkun dhe dhinë. Pra, një fjalë e urtë popullore thotë: “Prej zorit bëhen bashkë ujku dhe dhia”. Nga kjo që po shohim sot, kur shohim bashkë kryetarin e Parlamentit dhe të mandatarin për kryeministër, dihet qartë se kush është ujku, e kush është dhia.

E kur i shohim këta njerëz në maje të pushtetit, vërtet një shumicë e caktuar parlamentare ia ka vënë majën. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.

KRYETARI: E ftoj deputeten Emilija Rexhepi ta marrë fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem predsedniče i čestitam Vam novu funkciju!
Poštovani predstavnici međunarodnih organizacija,
Uvaženi ambasadori,
Kolege poslanici Republike Kosovo,
Medije,

Poštovani građani,

Bošnjačka zajednica pozdravlja potpisani sporazum o zajedničkom delovanju u narednom periodu između dve najveće političke opcije, i naravno da ćemo biti deo buduće Vlade, ali želim da za ovom vladom ponovim da je Bošnjačka zajednica najbrojnija od svih ostalih manjinskih zajednica u kosovskom društvu, te da po Ustavu Republike Kosova zaslužuje mesto ministra u izvršnoj vlasti, jer je zastupljena sa tri narodna poslanika, te se nadam da će to naš uvaženi budući premijer ispoštovati.

Takođe apelujem na rukovodioce buduće Vlade da je prioritet Bošnjačke zajednice proces decentralizacije, odnosno dobijanja opštine Rečan. Zatim, veliki problem naše zajednice je obrazovanje, odnosno proces nostrifikacije i priznavanje diploma naših građana, koji su u samom startu diskriminirani da konkurišu i zatraže bilo koju vrstu posla, a da ne govorim o kršenju Zakona o zaposlenosti manjinskih zajednica, koji se direktno reflektuje na veliku nezaposlenost i migraciju Bošnjaka u zemljama zapadne Evrope.

Nadam se ćete ovu problematiku početi da rešavate, jer je Bošnjačka zajednica integrisana u novo kosovsko društvo, te se na svaki mogući način, svakim danom, afirmiše u sve sfere života, ali mi to gospodo ne možemo sami, nego ste i vi kao Vlada odgovorni, naravno u svu pomoć međunarodnih ambasada, koja nam je više nego neophodna u ovom momentu, radi opstanka i ostanka Bošnjaka na prostorima Republike Kosovo, gde vekovima živimo kao autoktoni narod. Zahvaljujem!

KRYETARI: E ftoj deputeten e “Vetëvendosjes”, zonjën Puhije Demaku

PUHIJE DEMA KU: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të trupës ndërkombëtare në Kosovë,

Me qeverisjen e PDK-së përgjatë viteve të kaluara, Kosovës iu vunë themelet e diktaturës, ndërsa sot u betonua dhe u instalua përfundimisht regjimi autoritar që shkel dhe ndëshkon, jo vetëm opozitën, por edhe çdo zë opozitar përbrenda koalicionit që është zhvilluar.

Sot, ju që ishit partnerë në rrugën e ndryshimit, u bashkuat dhe u bëtë partnerë në rrugën e krimit. Për zërin e arsyes përbrenda koalicionit sot nuk mjafton vetëm vota kundër. Madje, ju kisha kërkuar të mos fshiheni as pas abstenimit. Nuk mjafton besa as dorëheqja. Sot ju, që për arsye parimore jeni kundër kësaj qeverie, ju ftoj që të distancoheni publikisht nga ky grup dhe nga kjo marrëveshje që e cenon lirinë dhe integritetin tuaj dhe të atyre që ju votuan ju si deputetë të këtij Parlamenti.

Të nderuar ambasadorë,

Të nderuar përfaqësues diplomatikë në Kosovë,

Do t'i kisha disa pyetje për juve sot: a i ka edhe më tutje kandidati për kryeministër 70 dosje në Prokurori? A i përmbush ai kriteret që ju i vlerësoni te partnerët, kur ju flitni se nuk doni njerëz që janë të korruptuar dhe që janë pjesë e krimit të organizuar? Flitni sot nëse janë këta njerëz në përputhje me këto kritere dhe me vlerat evropiane? Na thoni, a

ndërtohet e ardhmja evropiane e Kosovës me njerëz që kanë të tashme dhe të kaluar të kriminalizuar?

Kandidati për kryeministër na ligjëroi për lirinë, ndërkohë që marrëveshja e sotme, nëse e lexoni me vëmendje, përmban diçka tepër shqetësuese. Ajo e instalon definitivisht diktaturën, edhe për ju që jeni pjesë e koalicionit, duke ju mohuar të drejtën për të votuar mocione mosbesimi kur ato ngrihen nga grupet e tjera parlamentare.

Zoti Mustafa, kisha edhe disa pyetje për ju, sepse më 10 shtator ju e vutë një nënshkrim në një marrëveshje: A jeni ende për hetim të SHIK-ut? A jeni ende për hetim të privatizimit? A jeni për luftim të korrupsionit dhe krimit të organizuar?

Dy ditë pa u bërë tre muaj nga kjo marrëveshje, ju iu bashkuat SHIK-ut, ju iu bashkuat krerëve të krimit dhe të korrupsionit, dhe ekspertëve madje të korrupsionit, prandaj ata që deri sot kanë menduar për dinakërinë tuaj, më 19 nëntor u bindën edhe publikisht për këtë.

Programi qeverisës që e prezantuat ju na tregoi dy gjëra: se nuk fiton shoqëria e shteti me një humbës lokal dhe se ky popull, mbase ka të ardhme evropiane, por si shtet anëtar jo edhe për disa vite, por vetëm si qytetarë, të cilët ikin nëpër kampet dhe nëpër burgjet e shteteve anëtare BE-së. Për fat të keq, kjo është Qeveria që është para jush sot, dhe ju vendosni se kujt ia jepni votën.

KRYETARI: E ftoj deputetin Rustem Berisha nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

RRUSTEM BERISHA: Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Mysafirë,

Parafolësit e mi thanë shumëçka për gjendjen, për situatën e rëndë në Kosovë, në të gjitha sferat. Nuk kisha dashur të përsëris se në çfarë shtate jemi, duke u nisur prej të rinjve e studentëve që për çdo ditë e shohin perspektivën jashtë, për invalidët, veteranët, pensionistët e shumë të tjerë. Ne e dëgjuam edhe programin e të nominuarit Isa Mustafa, por atë çështja që unë desha ta ngre ka të bëjë me atë se nuk e dëgjuam listën e ministrave dhe po më intereson se cilat janë kriteret apo pengesat, komisionet, pse deri me tani u fol dhe u përfol emri i Anton Qunit për ministër të FSK-së, e tani nuk e shohë kolegun tim këtu?

A është ky një respekt që i bëhet betejës të Koshares? Cila është pengesa? Pse, ose cilat janë ato pengesa që i bëhen atij që të mos jetë ministër i Forcës të Sigurisë? Kjo është çështje që po na brengos ne të gjithëve dhe vërtet pritjet dhe respekti i qytetarëve edhe ndaj Betejës së Koshares, por edhe ndaj zotit Quni e kanë treguar edhe me votën e vet, prandaj nuk di, kisha dashur ta marr përgjigjen e të nominuarit, a mos janë pengesa të cilat vetë këtu njerëzit që janë sot prezent, i kanë bërë për disa individë e që sot janë pengesë të mos propozohen ose të mos kandidohet ministri Anton Quni. Faleminderit!

KRYETARI: E ftoj deputetin Mutaher Haskuka nga “Vetëvendosja”.

MYTAHER HASKUKA: Të nderuar qytetarë,
Deputetë,
Anëtarë të Kryesisë së Kuvendit,
Përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar,
Për gjashtë muaj Parlamenti u nënçmua dhe u përbuz, nënçmimi dhe përbuzja kulminoi
dhe sot.

Urgjenca e mbajtjes së seancës, dërgimi i ftesës deputetëve të dielën pas dite, më paka se
njëzet orë para mbajtjes së seancës, duke shkelur procedurat e Kuvendit, duke mos
shpalosur programin qeverisës dhe Kabinetin Qeverisës, të gjitha këto janë nënçmim dhe
përbuzje për Kuvendin.

Kjo tregon që kjo qeveri që është në ardhje, është ajo e mjegullës dhe e kontrabandës.
Kjo procedurë na humb shpresat për një qeverisje të mirë, shpresat që do të luftohet krimi
dhe korrupsioni, do të ndërtohet shteti i së drejtës, do të zhvillohet prodhimi vendor dhe
punësimi. Pra, humb shpresën e qytetarëve të Kosovës për dinjitet.

Për të na humbur shpresat janë edhe pikat 13 dhe 14 të marrëveshjes politike LDK-PDK.
Këto pika pamundësojnë vullnetin e deputetëve për iniciativë dhe ligjvënje. Këto dy pika
e vënë Qeverinë mbi Kuvendin dhe mbi demokracinë. Kjo është pikërisht njëra ndër pikat
kritike, e ngritur nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian, që në të kaluarën ka
munguar mbikëqyrja e Kuvendit ndaj Qeverisë.

Ne do të punojmë që kjo të ndryshojë, që t'ia kthejmë dinjitetin Kuvendit të Republikës
dhe dinjitetin e qytetarëve. Prandaj, u bëj thirrje qytetarëve të ndalin eksodin dhe të mos
kërkojnë dinjitet duke kërkuar azil rrugëve të Evropës. Kjo qeveri ka vetëm një të mirë, e
ka demaskuar koalicionin e fshehtë, që ka ekzistuar ndërmjet liderëve të këtyre dy
partive. Dhe, ky koalicion i fshehtë i ka hutuar zakonisht qytetarët, por tanimë qytetarët e
shohin të vërtetën, nuk ka më hutë.

Unë i siguroj qytetarët që kjo qeveri ashtu siç është e kontrabanduar nën mjegull, nën
urgjencë, ajo ashtu do të shkojë, ngase tanimë nuk kemi maska. Prandaj, i ftoj qytetarët
që së bashku të punojmë në Kosovë, të mos shkojmë Evropës, t'i kthejmë dinjitetin së
pari Kuvendit dhe pastaj edhe dinjitetin e qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Ftoj deputetin e “Vetëvendosjes”, Ismail Kurteshin.

ISMAIL KURTESHI: Të nderuar të pranishëm,
Unë nuk do të flas sot për pozitën, në të cilën ata që po e propozojnë këtë qeveri i kanë
pru deputetët e Kuvendit të Kosovës, që ta votojnë një qeveri pa e pasur programin
qeverisës në dorë, sepse për atë folën parafolësit e mi.

Një gjë e tillë sigurisht se as nuk mund të mendohet në vendet e ambasadorëve që janë
sot këtu prezentë dhe besoj që ata edhe do ta kenë parasysh se në çfarë kushte dhe në
çfarë pozite sillen deputetët e Parlamentit të Kosovës, por unë do të flas për efektet e para
të marrëveshjes LDK-PDK, menjëherë pas publikimit të saj.

Menjëherë pasi u bë publikimi i kësaj marrëveshjeje, efektet e para janë largimi i mijëra të rinjve nga Kosova, sepse me këtë marrëveshje atyre iu mbyl shpresa dhe sigurisht që qeveria e re nuk do të ketë nevojë të luftojë për liberalizim të vizave, sepse rinia kosovare në përfundim po arrin edhe pa i liberalizuar ato, duke gjetur rrugë ilegale e që është një dëm shumë i madh për këtë vend.

Po ashtu, do t'i them dy-tri fjali për përkushtimin e dy të parëve të qeverisë së ardhshme. Isa Mustafa ka mundur edhe para gjashtë muajve, më 9 qershor t'i bashkëngjitet PDK-së dhe të jetë pjesë e koalicionit. Nuk e ka bërë këtë sepse ka qenë i vetëdijshëm se atëherë nuk do të bëhet kryeministër, prandaj ka lidhur marrëveshje me shumë subjekte politike për ta realizuar këtë që sot po e realizon dhe e ka arritur një gjë të tillë.

Hashim Thaçi ka rrotulluar çdo gur për të mbetur në pushtet dhe edhe ai nuk ka kaluar keq, është bërë zëvendës i Isës, por, cila do të jetë kjo qeveri?

Kjo qeveri do të mbahet në mend për rahatimin e njerëzve të caktuar në këto dy subjekte. Për këtë flet edhe marrëveshja politike e nënshkruar nga dy të përmendurit, që i ka përafërsisht tri faqe tekst dhe prej atyre tri faqeve vetëm tri fjali flasin për programin qeverisës, kurse pjesa tjetër flet për pozitat e njerëzve të caktuar, madje duke caktuar edhe nga dy zëvendësministra në secilën ministri thuajse volumi i punëve është i barabartë në secilën ministri, dhe atë njërin të LDK-së tjetrin të PDK-së, e disa do të kenë madje edhe zëvendësministra të minoriteteve.

Kjo qeveri do të mbahet në mend si qeveria më e madhe në Evropë e shtetit më të varfër në Evropë.

Dhe, për të mos e zgjatur, e kam vetëm edhe një pyetje për zotin Isa Mustafa: a do të jenë pengesë ato akuza, që i keni një 70 nga Komuna e Prishtinës, për të cilat duhet të përgjigjeni në udhëheqjen e mëtutjeshme të Qeverisë së Kosovës?

Shpresoj që këta, po kjo shpresë ka humbur, në vend se të përkushtohen për vetveten, së paku një pjesë të përkushtimit ta ndajnë për qytetarët e Kosovës, po vështirë se do të ndodhë një gjë e tillë. Ju faleminderit!

KRYETARI: E ftoj deputetin Albin Kurti nga Lëvizja “Vetëvendosje”.

Sido që të jetë, kërkoj falje në kuptimin e asaj, se është seanca e parë. Megjithatë, unë e përcaktoj rendin e ditës, edhe pse qenka edhe Besnik Bislimi, por e bënë një ndërrim Lëvizja “Vetëvendosje” me Ismail Kurteshin, më herët ma sollën një letër.

Besnik Bislimi është edhe një emër nga Lëvizja “Vetëvendosje”, në qoftë se është për diskutim.

BESNIK BISLIMI: Zonja dhe zotërinj,
Vendorë dhe ndërkombëtar,

Në fillim kisha dashur t'i përgëzoj partnerët e koalicionit për shpejtësinë e rrufeshme, me të cilën e kanë arritur marrëveshjen më datën e 19 nëntorit.

Në të njëjtën ditë unë kam porositur tri pica në një piceri të qytetit dhe ka zgjatur më shumë kohë derisa ato kanë ardhur në shtëpi, se sa juve që ju është dashur për ta ndarë atë tortën, aq shumë të dëshiruar nga disa prej deputetëve të PDK-së. Është fjala për një tortë prej 6 miliardë eurosh për katër vjetet e ardhshëm, të cilën ju e keni ndarë në më pak se 60 minuta.

Para se të votoj për ose kundër Qeverisë, të cilën do ta prezantojë i nominuari zoti Mustafa, kisha dashur të kem disa informata shtesë prej tij.

Në ekspozenë e tij, zotëri Mustafa na premtoi se do t'i ulë të gjitha tatimet, disa prej tyre do t'i përgjysmojë, që do të thotë se presim një buxhet më të ulët gjatë vitit 2015 dhe në vitet në vijim. Në të njëjtën kohë na u premtua se do të shtrohen të gjitha rrugët e Kosovës, kompanive iu prematuan subvencione pa kufi, fermerëve stimulime, punëtorëve iu premtua se papunësia do të zbutet e bëhet pambuk, kategorive sociale iu premtua mbështetje e pa rezervë, na u premtua zgjidhja e problemit të energjisë, ujit të pijes, kanalizimit, u shtua edhe buxheti për bujqësi dhe shëndetësi.

Në të njëjtën kohë u përgjysmuan të hyrat buxhetore dhe u trefishuan shpenzimet buxhetore. Kisha dashur të di se si mendohet të arrihet kjo?

U tha se do të mobilizohen fondet e ndryshme, përfshi këtu Fondin e privatizimit, Fondin e diasporës dhe u tha mes tjerash "... dhe fondet tjera". Unë nuk di që Kosova ka fond tjetër, përveç Fondit të Pensioneve.

A mendoni se do t'i fusni duart edhe në Fondin e Pensioneve, ashtu siç ka premtuar vazhdimisht Partia Demokratike e Kosovës?

Premtimet që i dhatë ju, kërkojnë ndryshime thelbësore buxhetore. LDK-ja ka qenë partia e cila më së ashpri ka sulmuar buxhetin e vitit 2015, të cilin e ka përgatitur Qeveria në ikje. Kisha dashur të di se a mendoni që të ndryshoni këtë buxhet, apo do vazhdoni me të njëjtit numra që janë prezantuar deri më tani?

Ju përkujtoj se eksperti juaj për ekonomi, zotëri Hoti, ka cekur se me këtë buxhet që kemi, Kosovës do t'i duhen 28 vjet për t'i dyfishuar të ardhurat kombëtare, ndërkaq, me premtimet e zotit Mustafa për katër vjet, edhe Sllovenia do të na ketë lakmi. A mendoni që do të ndërhyjnë në këtë buxhet apo jo?

U tha se gjatë mandatit të ardhshëm qeveritar demokracia do të forcohet edhe më tej, demokracia e qytetarëve. A mendoni se mund të forcohet demokracia e qytetarëve, në qoftë se në vetë marrëveshjen e juaj e keni betonizuar nënshtrimin apo subordinimin e Parlamentit, kur thoni se deputetët apo grupet parlamentare do të punojnë në vazhdimësi për t'i arritur qëllimet e ekzekutivit dhe në të njëjtën kohë ua përcaktoni qartë deputetëve se çka guxojnë të votojnë dhe çka nuk guxojnë të votojnë.

Na thatë se nëpërmjet marrëveshjes suaj se i keni përqafuar vlerat e njëjta për ekonominë e lirë dhe për konkurrencën dhe në të njëjtin dokument premtoni se në mënyrë të

barabartë do t'i ndani të gjitha pozitat e institucioneve dhe agjencive të pavarura të krijuara nga ky Kuvend.

Ju kujtoj se një prej këtyre agjencive është edhe Agjencia Antikorrupsion dhe të tjera. A mendoni që edhe këto pozita t'i ndani në tentativën e juaj për të forcuar demokracinë dhe për të fuqizuar ekonominë e tregut?

U tha më parë se kjo qeveri nënkupton kapje të shtetit. Unë nuk mendoj se kjo është kapje, meqë kapja ka ndodhur më herët, kjo është një ridizajnim i kapjes dhe atë në dy aspekte, ridizajnim ndërmjet partnerëve dhe një ridizajnim në formë. Deri më tani kapja e shtetit ka ndodhur në mënyrë gjentëlmene, në mënyrë të fshehtë, kurse tani është e legjitimuar me një dokument zyrtar. Faleminderit!

KRYETARI: E ftoj deputetin Daut Haradinaj, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Mysafirë ndërkombëtar,

Nuk po e zgjas shumë se shumë u fol, por i kam menduar tri-katër pyetje, fillimisht për të nominuarin, për kryeministrin zotin Isa Mustafa dhe e para është: A është kjo Partia Demokratike, që të ndihmoj për ta rrëzuar Fatmir Sejdiun nga presidenti i Kosovës dhe po ashtu nga kreu i LDK-së? Pikërisht duket që edhe ky koalicion, sikurse e rrëzuat Fatmir Sejdiun, natën, u arrit marrëveshja edhe me Thaçin.

Ajo që po përflitet shumë në popull tash e dy javë, sidomos për ish luftëtarë të UÇK-së, bashkëluftëtarë të mi të PDK-së, a është ky Isa Mustafa ministër i Rrahman Morinës? A është ky Isa Mustafa dhe LDK-ja titiste, të cilën sot keni për ta votuar?

Kjo është që ju me siguri në të ardhmen keni për t'i dhënë përgjigje elektoratit. Në të njëjtën kohë, disa miq të mi në LDK që janë përballë atje e kanë akuzuar pikërisht këtë njeri këtu si njeri i nëntokës, i krimtit, si njeri që ka vra pas luftës mbi baza politike, a është ky njeri sot që ju e votuat për kryeparlamentar?

Një pyetje tjetër që duhet t'ua bëj juve të gjithëve këtu që e keni votuar sot Kadri Veselin dhe më vonë ministër që do ta votoni Isa Mustafën për kryeministër, a janë këta LDK-ja që kanë mbledhur dosje kundër luftëtarëve të UÇK-së apo është një LDK tjetër tash në sallë? A është kjo LDK që edhe sot e kësaj dite keni kryetarë të komunave, ambasadorë që akuzohen për krime lufte dhe pikërisht njerëz të LDK-së i dalin dhe dëshmojnë kundër tyre dhe ju sot pa fije turpi me aplaudim do ta votoni.

E di që nuk keni qare pa e votuar se jeni të shantazhuar dhe jeni të kapur, por mos harroni se populli i Kosovës shumë shpejt ka për t'ju larguar prej këtu. Faleminderit!

KRYETARI: E ftoj deputetin e Partisë Liberale Egjiptiane, zotin Veton Berisha.

VETON BERISHA: I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar mysafirë,
Më lejoni që edhe unë t'i them një dy fjalë në këto orë të vona pas krejt këtij debati. Do të mundohem të jam i shkurtër.

Unë përfaqësoj komunitetin egjiptian të Kosovës dhe detyrohem që të dalë këtu para jush dhe para opinionit të gjerë dhe të deklarohem se unë do të hyj në qeverisje dhe do të votoj këtë qeverisje.

Por do t'i kemi disa kushte të cilat mua më obligon edhe komuniteti dhe situata në të cilën ne jemi duke kaluar.

Sot nuk u ndjeva mirë për shkak se përpos që komunitetit egjiptian i ka humb dinjiteti që një 15 vite sot edhe nga grupi parlamentar ose nga vet komuniteti pakicë i cili është minoritar në Kosovë e shkel nenin 67 dhe nuk e përfshin komunitetin egjiptian në Kryesinë e Parlamentit të Republikës së Kosovës.

Sot komuniteti egjiptian lihet anash për shkak se privilegjohet komuniteti serb. Në rregull, është veprim politik, mirëpo, komuniteti egjiptian e ka zbrazur Kosovën, është zbrazur.

Ka një 4 muaj kur unë këtu para kësaj foltore ardhur dhe ka qenë seanca e Bllokut dhe kam ardhur për të vetmin qëllim për ta paraqitur shqetësimin tim kur nuk ka pasur mundësi tjetër kund. Domethënë, nuk ka pasur mundësi që unë as në media, as para zyrtarëve tjerë ta paraqes shqetësimin e largimit masiv të komunitetit egjiptian dhe kam shfrytëzuar foltoren dhe kam ardhur e kam paraqitur këtë rezyme.

Tani, gjatë gjithë kohës, çdo folës e tha që ka filluar të dalë edhe komuniteti shqiptar. Singërisht, nuk po më bën të ndihem mirë, por për një fakt po ndihem mirë sepse me këtë rast po përfiton edhe komuniteti egjiptian, sepse u sensibilizua opinioni, u sensibilizuan ndërkombëtarët, u sensibilizuan Forcat e Sigurisë të cilat veç i ndërmarrën masat dhe kjo ndodhi pas një 6 muajve. Domethënë, pas 6 muajve u ndërmor një veprim ku sot ndoshta komuniteti im po privilegjohet.

Unë do të hyj në qeverisje, por do t'i paraqes kushtet e mia të cilat sigurisht që do të mundohem t'ia kthejë dinjitetin komunitetit tim. Komuniteti im është 99% i papunë. Komuniteti im jeton në varfëri ekstreme. Komunitetin të cilin unë e përfaqësoj braktisë çdo ditë shkollat, braktisë çdo ditë procesin mësimor dhe komuniteti im nuk trajtohet as i dorës së parë, as i dorës së dytë, por ndoshta i dorës shtatë, tetë, nëntë, dhjetë a ku e di unë më tepër.

Me këtë rast, edhe pse do të mbështes qeverisjen, do të hyj brenda, unë do t'i kam kushtet e mia dhe besoj se do të përfaqësohem denjësisht dhe do të shfrytëzoj të gjithë potencialin tim edhe intelektual, edhe personal që komuniteti egjiptian të jetë i trajtuar ashtu siç e meriton, ashtu siç i ka kontribuar të gjitha proceset ku ka kaluar Kosova dhe kërkoj singërisht që të trajtohet i barabartë e në veçanti nga vetë komunitetet pakicë të

cilat e ndiejnë shumë mirë se si është me qëndruar komunitet pakicë, ndërsa unë sot përfaqësohem nga ministri aktual, ministri i cili do të jetë ministër dhe përfaqëson Grupin “6+”, ndërsa del dhe flet këtu në emër të komuniteteve jo shumicë jo serbe dhe jo shqiptare dhe mua as që më konsulton se a duhet të jem i trajtuar ma mirë apo jo.

Domethënë, në anën tjetër komuniteti egjiptian, përpos asaj që kërkon nga populli shumicë të jetë i trajtuar ashtu siç duhet, kishte me qenë mirë që sinqerisht ky komunitet të trajtohet në një prioritet të shtuar dhe të ketë kujdes me rastin e kthimit të këtij komuniteti në Kosovë, mos të kthehet ky komunitet në Kosovë deri sa të sigurohen kushte për jetesë. Nuk po kërkojmë asgjë më tepër, përpos asaj që të ketë kushte elementare për jetesë, të ketë një zhvillim, të ketë investim në kapital, të ketë mundësi të barabarta të zhvillimit dhe të trajtohet si qenie njerëzore e jo si persona të dorës së dytë dhe të tretë.

Po shpresoj se sonte do të procedojmë me qeverisjen, do ta mbështesim, mirëpo nuk do të qëndrojmë zë i heshtur por do të kërkojmë të gjitha ato që neve na takojnë. Faleminderit edhe një herë!

KRYETARI: E ftoj deputetin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotin Bali Muharremaj.

BALI MUHARREMAJ: Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Para gjashtë muajve menduam që do të vjen një pushtet, me të vërtetë që ka për ta çuar çështjen dhe zhvillimin ekonomik përpara.

Mirëpo, në bazë të programit të cilin e dha më herët mandatar i ardhshëm i Republikës së Kosovës, unë e pashë që aty nuk do të ketë zhvillim ekonomik, nuk do të ketë vende të reja të punës, nuk do të ketë arsim cilësor.

Mirëpo, kjo është një vazhdimësi e qeverisë e cila ka qenë deri më tash, dhe ka për të vazhduar edhe një rugë.

T’ju them të drejtën jemi duke jetuar në shekullin XXI. 15 vjet pas luftës nuk ka vende të reja të luftës, nuk ka zhvillim ekonomik, ka filluar të zbrazet Kosova. Ku t’i çojmë të gjitha gjeneratat që janë duke diplomuar çdo vit?. Ku t’i çojmë njerëzit që janë duke magjistruar çdo vit?

Prandaj, edhe një herë po them, që ne si Aleancë do të jemi opozitë konstruktive derisa është edhe qeveria konstruktive, përndryshe do të punojmë për interesin e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: E ftoj deputetin e Vetëvendosjes, Albin Kurtin ta marrë fjalën.

ALBIN KURTI: Të nderuar qytetarë të Republikës,
Deputetë të Kuvendit dhe ju pjesëmarrës të tjerë në këtë seancë,

Derisa nuk ishin formuar institucionet pas zgjedhjeve të 8 qershorit, kishim krizë të butë në sistemin politik.

Tash kur po formohen institucionet, nis thellimi i vërtetë i krizës dhe rëndohet gjendja për qytetarët e Kosovës drejt shpërthimit.

Populli t'ne më shumë vuan nga funksionimi i institucioneve sesa nga mosfunksionimi i tyre, për shkak të orientimit të mbrapshtë që kanë institucionet dhe udhëheqjes edhe më të mbrapshtë.

Sot është dita më e errët për sistemin politik në Kosovën e pasluftës. Në njërin anë, kreu i Shërbimit Sekret të PDK-së u bë kryeparlamentar dhe tash interpreton Rregulloren e Kuvendit të Republikës, në anën tjetër, dy parti që po rrudhen, u bënë bashkë për të sjellë edhe më shumë gjëra të njëjta: korrupsion në qeveri e mjerim në popull, privatizim në ekonomi e koncesione ndaj Serbisë.

Nëse shikohen votimet e deputetëve në mandatin e kaluar, ata që rregullisht kanë votuar për privatizimet e egra dhe pazaret me Serbisë, si askush tjetër, ishin pikërisht agjentët e SHIK-ut që e përbënin gjysmën e Grupit Parlamentar të PDK-së.

Në mandatin kaluar ne e patëm marrë nismën për një Komision Hetimor Parlamentar për SHIK-un dhe i patëm mbledhur asokohe 27 nënshkrime. Tash, në këtë mandat, në Legjislaturën V, jemi së paku 33 deputetë të opozitës dhe kur të na bashkohen edhe 8 deputetë të LDK-së që votuan kundër Veselit, kjo është më se e mjaftueshme që ne ta formojmë këtë Komision Hetimor Parlamentar për SHIK-un.

Kjo është shumë e domosdoshme. Nuk ka shtet demokratik, nuk ka Republikë Parlamentare, nuk ka drejtësi ligjore, pa e hetuar dhe zbardhur çështjen e SHIK-ut.

15 vjet në Kosovë kanë bashkëjetuar SHIK-u dhe UDB-a pa u përleshur askund asnjëherë. Ndoshta nuk kishte zatetje që të ketë përleshje mund të thotë dikush? Apo, ndoshta, kishte zatetje pa përleshje, do të thosha unë.

Po të ishte SHIK-u kundër Serbisë do të merrej me strukturat e Serbisë, sidomos, në veri dhe me njerëz si Ramiz Kelmendi, por jo me Lëvizjen “Vetëvendosje”.

Për një dekadë është ushtruar e pajisur SHIK-un në Kosovë. Erdhi koha e mirë si asnjëherë më parë, që këtë dije e përvojë SHIK-u ta përdorë në veri të Kosovës pas shpalljes së pavarësisë dhe atëherë kur PDK-ja e mori pushtetin, mirëpo jo: ata u morën dhe merren vetëm me Lëvizjen “Vetëvendosje” e kundër saj, por edhe kundër LDK-së, e cila tash bleu paqen e turpshme duke e shitur veten.

Agjentët e SHIK-ut janë shpallur fajtorë në gjykata e janë dënuar me ç’rast disa prej tyre ndodhen në arrati. Në dëshminë e tij para prokurorit të EULEX-it, kreu i SHIK-ut, Kadri Veseli, sipas gazetës Koha Ditore të datës 1 shtator 2011, ka deklaruar se ka pasur kontakte dhe bashkëpunim me bashkëpunëtorë të Serbisë me ç’rast njeriu i ngarkuar për

këtë bashkëpunim kishte qenë hiç më pak se drejtori i përgjithshëm i SHIK-ut, Ferat Shala, i cili, deri vonë ishte drejtor i përgjithshëm i “Trepçës” gjithsesi shtet i kapur dhe tash LDK-ja i kapet vetë kapjes së shtetit.

Në një takim që kishim me Isa Mustafën, ai pati thënë që as UDB-ja nuk ishte e keqe si këta të SHIK-ut. Se SHIK-u janë më zi se UDB-a, kurse publikisht ka deklaruar se krerët e SHIK-ut i kanë duart me gjak, tash, po ky i njëjti po synon të bëhet kryeministër në shtetin e kapur nga SHIK-u dhe nga PDK-ja. Kombinimi i lakmisë personale për pushtet me frikën nga mund ta shpijnë ato 70 dosje për Komunën e Prishtinës, të po këtij personi, e formoi këtë koalicion.

Në ish-koalicionin LAN, çështja ishte nëse prioritet është shumica parlamentare apo posti i kryeministrit. Gjatë pesë muajve prioritet ishte shumica parlamentare, por në fund u rikthye mëkati fillestar, posti i kryeministrit, dhe u shkatërrua shumica parlamentare. Isa Mustafa iu nënshtrua PDK-së dhe u bë pjesë e shtetit të kapur dhe kapjes së shtetit. Shumica parlamentare nuk u prish prej poshtë, prej anëtarësisë, dhe prej deputetëve të LDK-së, por u prish prej lart, prej krerëve të partive.

Kosova është një vend ku borxhet private të politikanëve për pushtet bëhen borxhe publike të qytetarëve që mbijetojnë. Tash, mund ta ketë thënë edhe dikush tjetër, ndoshta shumë të tjerë, por unë që prapë e kam dëgjuar prej Ismet Beqirit se nuk shkojnë me PDK e me SHIK asnjëherë për shkak se edhe profesor Sabri Hamiti nuk e ka plagosur UDB-ja, por këta të SHIK-ut.

Dhe, unë sot e pashë se si profesor Hamiti e ngre dorën për atë që u instalua si kryeparlamentar. Tash, profesor çfarë të bëjmë me ata libra që i ke shkruar? Çfarë të bëjmë me titullin akademik? Çfarë të bëjmë me doktoraturën e juaj? Se, për doktoraturën e këtij që po e kryen duhet t’ia marrim atij që po ia jep doktoraturën këtij, e lërë më ky që s’duhet ta marrë doktoraturën.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Ju kisha lutur deputetë, le të vazhdojë deputeti. Ju lutem, qetësi!

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Republikës,
Ndryshimi pozitiv në Kosovë e për Kosovën nuk mund të ndodhë me PDK-në, por në opozitë me ta.

Ata që nuk e përjashtojnë mundësinë e koalicionit me PDK-në, e përjashtojnë Kosovën nga mundësia e ndryshimit. Ata që kanë bërë koalicion me PDK-në kanë zhbërë vetveten në kapje të shtetit.

S’ka dyshim që PDK-ja është korporata më e fuqishme në Kosovë. Ajo është shoqëri aksionare publikisht e së jashtmi, kurse privatisht së brendshmi është biznes individual ose familjar i aksionarëve. Në fakt, moti ishte kështu. Tash, më shumë janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, ku kapitali nuk ndahet në aksione, por themeluesit përgjigjen

vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar, të tjerët aty janë argat me pagesë.

Parulla e PDK-së ju e dini cila është: “Familja, prona, shteti”. Pra, shteti në funksion të pronave të familjes. Me PDK-në, ju LDK-ja s’mund të bëni koalicion. Me PDK-në nuk është i mundshëm koalicioni. Me PDK-në duhet të bëheni një familje. Pra, duhet me hy në familje se koalicioni nuk është i mundshëm e ju, pikërisht këtë gjë e keni bërë, keni hyrë në një familje me ta.

Marrëveshja e 10 shtatorit parashihte komisione hetimore parlamentare sipas nenit 71 të Rregullores së Punës së Kuvendit për dialogun e privatizimet e deritanishme dhe rezultatet e tyre, duke e përfshirë këtu edhe mekanizmin e Komisionit të Venedikut. Te PDK-ja nuk shkoi Mustafa me qëndrimet e marrëveshjes së 10 shtatorit, që i ka nënshkruar vetë, pra edhe një dëshmi më shumë se iu nënshtrua vizionit a misionit, a si të doni quajeni, të PDK-së. Për një marrëveshje për të mirën e Kosovës, si ajo e 10 shtatorit, na u deshën 3 muaj. Kurse për të arritur një marrëveshje për të keqen e Kosovës, si ajo e 19 nëntorit të Presidentja, u deshën 3 minuta.

Programit qeverisës, që nuk u prezantua sot këtu, i mungonin po ashtu edhe emrat e kabinetit qeverisës. Neve po na kërkohet që njerëzit të votohen nga përshtypja e deritanishme, pa ua ditur njëherë as emrat dhe gjithsesi pa treguar çka do të bëjnë ata në katër vjetët e ardhshme të këtij koalicioni. Isa Mustafa foli për luftim të varfërisë, por për luftë të të pasurve të korruptuar nuk guxon të flasë. Të gjithë njerëzit që flasin për varfërinë, pa folur për të pasurit, janë hipokritë. Nuk mund të flasësh për të varfrit pa folur për të pasurit. Nuk mund të flasësh qysh dikush u bë i varfër, pa e këqyr qysh u bënë të pasur këta që u bënë të pasur.

Tash, çështja themelore është nëse do të luftohen krimet financiare të Gani Thaçit? Një ndër kriminelët më të mëdhenj në Kosovë që ka mundur të jetë një qytetar shumë i mirë i Republikës po të mos i qëllonte vëlla Hashimi. Por, i ka qëlluar vëlla Hashimi dhe u bë njëri ndër kriminelët më të mëdhenj. A do të luftohet ai? A do të luftohen krimet tregtare të Ramiz Kelmendit? Ai që bën importe me mallrat e Serbisë, që i sjell këtu. A do të luftohen këta njerëz? Sigurisht që jo. Mos harroni zoti Mustafa, por edhe nëse harroni këtë ua përkujtojmë, se këta të PDK-së kanë shumë vëllezër. Dhe, vëllezërit nuk i kanë për të shtëpia, por për kurriz të popullit. Parulla e tyre, edhe një herë, është: “Familja, prona, shteti”, ku fjala ‘familja’ lexohet italisht qysh na kanë mësuar këta protagonistët e ‘Pronto’-aferës, pra ‘La Famiglia’. Faleminderit!

KRYETARI: E ftoj kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, zotin Hashim Thaçi.

HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar Veseli,

Të nderuar deputetë,

Koalicioni Partia Demokratike e Kosovës & Lidhja Demokratike e Kosovës është rezultat i vullnetit të lirë, i përgjegjësiive politike, i respektimit të Kushtetutës, të ligjeve, të respektimit të plotë të rezultati zgjedhor të 8 qershorit, si dhe i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Është një orientim për themelimin e institucioneve legjitime, funksionale, me përfshirje edhe të të gjitha komuniteteve në ndërtimin e institucioneve multietnike dhe gjithëpërfshirëse.

Natyrisht se zërat kritikë që mund të dëgjohen për këtë koalicion janë e drejtë e secilit që ta shprehë opinionin e vet, por në të njëjtën kohë askush s'mund t'ia mohojë asnjë subjekti politik të lidhë koalicione me partinë me program të përafërt.

Edhe Partia Demokratike e Kosovës, edhe Lidhja Demokratike e Kosovës, e kanë një orientim të qendrës së djathtë, të konfirmuar tani edhe zyrtarisht.

Natyrisht se nuk mund të jenë bashkë në një koalicion partitë me program të ndryshëm, siç mund të jenë partitë e majta me të djathta, kështu që kjo është fare e thjeshtë. Dikush mendon për ekonomi të lirë të tregut, sikur ne që mendojmë, dhe programi i Qeverisë është përgatitur, do të kalojë nëpërmjet Qeverisë, vjen Kuvendit, diskutohet. I nominuari për kryeministër, zoti Mustafa, e prezantoi ekspozenë, që del prej programit të Qeverisë me mbështetje të plotë tonën, e që kanë punuar, dëshiroj t'i falënderoj grupet punuese, edhe për program, edhe për të gjitha angazhimet që i kemi pasur.

Unë jam i bindur se sot ne po i japim vendit tonë institucione stabile, kredibile e efektive të orientimit euroatlantik, të respektimit të rendit dhe ligjit, të urtësisë, të mençurisë dhe vendimeve të guximshme që i kemi marrë e do t'i marrim edhe në të ardhmen.

Tjetër? Nëse shikojmë edhe në të kaluarën, po këto dy parti i kanë vendimet më të rëndësishme, duke mos e mohuar, por edhe vlerësuar, edhe kontributin e të tjerëve. Më të rëndësishme për vendin, edhe për liri, edhe për çlirim, edhe për pavarësi, edhe për njohje, edhe për integritet, edhe për të gjitha proceset.

Unë sot dëgjova këtu, pa dashur me asnjërin të replikoj personalisht, kritika për dialogun. Ndërsa në momentin që ishin në një lidhje politike luftonin vetë ta udhëheqin dialogun, e tash sonte përsëri e kritikojnë dialogun. Tash le të vlerësojë vetë qytetari - cila është e moralshme?

Ne kur kemi zhvilluar dialog, dhe sot që e zhvillojmë përsëri, dhe nesër që do ta vazhdojmë përsëri, për çdo vendim që e kemi marrë më herët dhe do të marrim në të ardhmen, do të respektojmë Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Dhe, kjo ishte shumë e qartë edhe në ekspozenë e të nominuarit për kryeministër, zotit Mustafa.

Vendimet tona i ka konfirmuar edhe Gjykata Kushtetuese. Ndërsa për 5 muaj rresht kanë luftuar ta udhëheqin po këtë dialog që e kemi udhëhequr ne. Tash thonë s'bën!

Pjesëtarët e komunitetit serb në Kuvendin e Kosovës një kohë i quanin çetnikë, për një kohë u bënë bashkëpunues shumë të mirë, sot përsëri thonë nuk bëjnë. Ku është morali politik?

Tjetër? Dëgjova këtu gjëra që u adresuan në drejtim të zotit Mustafa, duke u thirrur në komunikimin me popullin, me qytetarët. Unë dua për të parë, flas për pas gjashtë muajsh, shumë hapur, para juve deputetë të nderuar, para të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, të theksoj se para se ta nënshkruaj marrëveshjen me zotin Mustafa, që të tri partitë që tash dolën jashtë, se nuk patën guxim të rrinë e të ballafaqohen, më kanë ofruar oferta për koalicion.

(Duartrokitje)

Por, rruga që e kanë ndjekur ata ka qenë kundërshtim me parimet tona të transparencës. Unë s'i kam bërë vija të kuqe askujt kurrë, as nuk i bëj në politikë. Për interes të shtetit, bashkëpunoj me të gjithë. Por, programet kanë qenë të kundërta. Madje, i kemi edhe me shkrim që na i kanë dërguar, mund edhe t'ua prezantojmë.

Me kryetarin Mustafa jemi takuar shumë publikisht dhe në mënyrë transparente. Ky është dallimi i rrugës së atyre që kërkonin të afrohen me ne, thjesht me Partinë Demokratike, duke qëndruar ditën me kryetarin Mustafa dhe duke vazhduar pasdite në selinë e PDK-së, një nga një, por duke kërkuar që të mos e marrin vesh njeri prej tjetrit. Ky është dallimi i marrëveshjes sonë transparente PDK-LDK dhe i punës pas shpine ndaj LDK-së, që ka ndodhur prej tyre.

Nuk kemi pranuar për arsye se ne jemi parti e qendrës së djathtë dhe në të njëjtën kohë qëndrimet e tyre politike, orientimet e tyre politike, kanë qenë plotësisht në kundërshtim me kriteret e qeverisjes evropiane dhe euroatlantike, se personalisht me asnjërin prej tyre nuk kemi asgjë. Konceptualisht, po. Do të thotë, kemi pasur dallime konceptuale.

Por, ofertat prej se tri partive i kam në zyrën time të PDK-së dhe mund t'i bëj publike, para se të takohesha me kryetarin Mustafa. Ne jemi takuar publikisht, ata po thonë në terr. Jo në terr, por në zyrën e Presidentes, kemi kërkuar të shkojmë bashkë me kryetarin Mustaf. E falënderojmë presidenten Jahjaga na ka pritur në zyrën e vet dhe në mënyrë shumë transparente. Nëse ata mendojnë se është marrëveshje e territ Zyra e Presidencës, e kanë gabim. Ne kemi kërkuar me vullnetin tonë të plotë, na ka pritur Presidentja, kemi arritur marrëveshje, kemi bërë marrëveshje parimore, e kemi bërë edhe programi dhe sonte kemi ardhur këtu.

Prandaj, të nderuar të pranishëm,

Deputetë të nderuar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Është momenti që pas pak çastesh ne t'ia japim vendit Qeverinë e Kosovës, Qeverinë që e kanë pritur qytetarët ndoshta shumë padrejtësisht plot 6 muaj, e vonesa ka ndodhur pikërisht nga ato ofertat pas shpinës ndaj njëri-tjetrit që kanë ndodhur më herët, e jo nga diçka tjetër.

Pra, ne kemi punuar me përgjegjësi të plotë, të gjithë duhet t'i kuptojmë edhe ata që thoshin 'jo nuk flasim me Thaçin, nuk flasim me PDK-në'. Kanë folur edhe shumë bile.

Kanë sjellë bile edhe letra bile. Shumë kanë folur. Për 'mësit' nuk e di, flas për ato që i kam parë dhe i kam takuar vetë, si kryetar i partisë.

Prandaj, marrëveshja është transparente, e përgjegjësive së lartë politike, e interesave kombëtare, e interesave euroatlantike, e vlerave të përbashkëta dhe natyrisht e interesave të përbashkëta shtetërore dhe euroatlantike.

Edhe një herë, të nderuar deputetë,
Në emër të partisë më të madhe të vendit, ju ftoj që me votimin tonë, që e kemi tani para nesh, të votojmë dhe t'ia japim vendit institucionet e Republikës së Kosovës dhe të vazhdojmë me punë. Bota nuk na pret. Bota po na shikon dhe pret prej nesh të marrim vendime të guximshme, vendime çfarë jemi duke i marrë edhe tash. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Grabovci, kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!
Propozoj për një pauzë prej gjysmë ore. Kemi nevojë për një konsultë të shkurtër së bashku dhe pastaj kthehemi.

KRYETARI: Atëherë pauzë gjysmë ore, pastaj do ta vazhdojmë prapë seancën, të nderuar deputetë. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

KRYETARI: Mirëmbërëma të gjithëve! Të nderuar deputetë, po e vazhdojmë seancën. E ka fjalën zoti Grabovci, nga Partia Demokratike e Kosovës.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!
Në konsultë me Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kërkojmë që vazhdimi i seancës të shtyhet për nesër në orën 12:00.

Një, ju garantoj pa shqetësimin më të vogël se numrat janë të mjaftueshëm, bile edhe për ju kemi.

KRYETARI: Ju lutem, më falni të nderuar deputetë!
Në një situatë të tillë kur zoti Grabovci foli në emër të dy grupeve më të mëdha parlamentare...

Më fal, zoti Ismet Beqiri!

ISMET BEQIRI: Po, edhe ne pajtohemi që seanca të vazhdojë nesër në orën 12:00.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë i kemi dy qëndrime të dy grupeve më të mëdha parlamentare në Parlamentin e Republikës së Kosovës. A kanë synim grupet tjera parlamentare që edhe formalisht për hir të respektit të bartin qëndrimin për shtyrjen të nesërmen të seancës?

Atëherë, “Vetëvendosja”!

VISAR YMERI: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Këtu u kërkua një shtyrje të seancës së jashtëzakonshme që ju vetë e keni thirrur dhe tash po kërkoni vetë për ta shtyrë, pa kurrfarë arsytimi. Pra, as që keni dhënë arsytim kur e keni thirrur, e as s’keni dhënë arsytim pse po doni ta shtyni. Tregoni pse po doni ta shtyni?

Ne jemi kundër për ta shtyrë këtë seancë dhe mendojmë që duhet shkuar krejt në shtëpi, dorën në zemër dhe ishte koha për të shkuar në shtëpi, po për të shkuar e për të mos u kthyer. E kjo seancë, kjo shtyrje që e keni kërkuar po thonë që keni për t’u kthyer. Dhe, ne e kundërshtojmë këtë shtyrje, sepse nuk po shohim kurrfarë arsyeje për shtyrje.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Më falni, e keni parasysh, është seanca e parë, edhe pse me Rregullore nuk kam asnjë obligim kur dy grupet e mëdha e kanë këtë qëndrim, për arsye se kalon menjëherë në votim.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Po më dhimbesh. Është dashur për ta lexuar Rregulloren pak më herët, se kurrkujt s’mund t’ia ndalësh fjalën, se qytetarët na e kanë dhënë të drejtën e debatit dhe të fjalës, e jo ju e as partitë politike, as më të mëdha e as më të vogla, por qytetarët drejtpërdrejt.

Edhe ne po ju pyesim, pse të shtyhet? Kosova ka pasur vonesa në themelimin e krijimin e institucioneve. Nëse s’i keni bërë pazaret, a i bëni sonete, apo qysh është tema deri në mëngjes?

Ne jemi kundër shtyrjes dhe konsiderojmë që kjo shtyrje edhe një herë reflekton pabesinë mbi të cilën e keni bërë këtë koalicion dhe jemi kundër. Do të vazhdojmë, nëse doni me debat dhe vazhdojmë me procedimin e themelimit të institucioneve.

KRYETARI: ‘Nisma’, ju lutem!

ZAFIR BERISHA: Ne nuk e kemi të qartë, mbledhja e jashtëzakonshme kur të thirret, sigurisht keni pasur kohë dy javë për t’u marrë vesh për atë kulaçin se s’mund po e ndani. Në fakt, unë po dyshoj që këtu mos është një intervenim pasi Lista Serpska s’është këtu, edhe Vuçiqi ende s’jua ka dhënë vizën për ta bërë qeverinë apo diçka tjetër?

Sido që të jetë, unë propozoj që Isa dhe vartësi i Isës, ministri i Punëve të Jashtme, me gjasë zoti Thaçi duhet të tregojë çka është në pyetje. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi “6+”! OK. Atëherë, për korrektësi, në mënyrë formale e hedhim në votim.

Kush është për shtyrjen e seancës për nesër në orën 12:00? Kush është kundër? A ka abstenim?

Atëherë konstatojmë se në sallë janë 101 deputetë të pranishëm. 69 prej tyre kanë votuar prë, 30 kanë votuar kundër dhe kjo është gjendja reale. Pra, seanca shtyhet për nesër, në orën 12:00! Faleminderit! Suksese!

* * *

E martë, 9 dhjetor 2014

Vazhdimi i mbledhjes së jashtëzakonshme, e filluar më 8 dhjetor

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli

KRYETARI: Mirë dita të gjithëve! Kërkoj falje paraprakisht për vonesën, e cila ishte objektive.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar mysafirë dhe përfaqësues të medieve,

Ky është një vazhdim i punimeve të mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar dje, më 8 dhjetor 2014.

Konstatoj se në sallë janë 113 deputetë.

Duke pasur parasysh se dje ka qenë dita e diskutimeve, e kemi një të nominuar për kandidat për kryeministër të Republikës së Kosovës. Atëherë e ftoj kandidatin e nominuar për kryeministër të Republikës së Kosovës, zotin Isa Mustafa, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë përbërjen e Kabinetit qeveritar.

ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues diplomatikë, të cilët jeni sot këtu në këtë seancë,

Unë sot po e prezantoj përbërjen e Kabinetit qeveritar, të cilin e kemi harmonizuar me partnerët tanë, me Partinë Demokratike të Kosovës, me Listën serbe, me Listën “6+” dhe me përfaqësuesit tjerë të pakicave:

I propozuar, përkatësisht i nominuar për kryeministër të Republikës së Kosovës jam unë (Isa Mustafa);

Zoti Hashim Thaçi është i propozuar për zëvendëskryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme;

Doktor Kujtim Shala, zëvendëskryeministër dhe ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;

Zoti Branimir Stojanović, zëvendëskryeministër;

Zoti Mahir Jagčilar, ministër i Administratës Publike;

Zoti Lubomir Mariq, ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal; Doktor Arsim Bajrami ministër i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; Zoti Valon Murati, ministër i Diasporës; Doktor Hajredin Kuçi, ministër i Drejtësisë; Doktor Abdullah Hoti, ministër i Financave; Zoti Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik; Zoti Bekim Çollaku, ministër i Integritetit Evropian; Doktor Haki Demolli, ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës; Zoti Aleksandar Jablanović, ministër për Komunitete dhe Kthim (Dëshiroj të ju njoftoj, sepse është hapur dhe diskutimi lidhur me të, ai ka dhënë dorëheqje në Kuvendin e Serbisë.); Doktor Ferid Agani, ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Zoti Arban Abrashi, ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale; Doktor Imet Rrahmani, ministër i Shëndetësisë; Doktor Lutfi Zharku, ministër i Infrastrukturës; Doktor Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë; Zoti Skender Hyseni, ministër i Punëve të Brendshme; Zoti Memli Krasniqi, ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Doktor Edita Tahiri, ministre pa portofol dhe Zoti Rasim Demiri, ministër pa portofol.

Ky është propozimi për Kabinetin qeveritar, sipas marrëveshjes së cilën ne e kemi me këtë koalicion. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Mustafa!

Atëherë, në sallë janë të pranishëm 115 deputetë. Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për Kabinetin e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

(Debat në sallë)

Atëherë, ju lus për votim. Më falni, dhe kishim debat. Të gjithë që kanë qenë të lajmëruar, kanë diskutuar. Besoj që nuk është mirë edhe para imazhit të qytetarëve ta prishim demokracinë tonë parlamentare. Ju lutem, votojmë për kryeministër. Me ngritje dore, ju lutem! Regjia!

Kush është për kryeministër Isa Mustafën dhe për Kabinetin e vet qeveritar?

Edhe një herë! Jemi duke votuar kush është për, votimi për kryeministër të Qeverisë, të udhëhequr nga zoti Isa Mustafa, kryeministër?

Regjia, numërojini ju lutem! Faleminderit!

A ka kundër? Faleminderit! A ka abstenim? Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

Atëherë, konstatoj se me 73 vota për, me 38 vota kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi e zgjodhi Qeverinë e re të Republikës së Kosovës me kryeministër zotin Isa Mustafa. Urime!

(Duartrokitje në sallë.)

Menjëherë e ftoj kryeministrin e ri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat që t'i zënë vendet e tyre, gjatë leximit të betimit nga kryeministri, të ngritën në këmbë. Ju lutem!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

Zoti kryeministër, atëherë është momenti i leximit të tekstit të betimit. Ju lutem!

Në të njëjtën kohë, i ftoj zëvendëskryeministrat dhe ministrat që të ngrihen në këmbë gjatë momentit të leximit të betimit nga kryeministri. Ju lutem!

ISA MUSTAFA: Ne, anëtarët e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, betohemi solemnisht se me përgjegjësi, me përkushtim dhe me ndershmëri do t'i kryejmë të gjitha detyrat dhe punët që i kemi sipas mandatit të dhënë nga ky Kuvend, gjithmonë duke e zbatuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjin dhe vendimet e miratuara, duke i respektuar parimet, normat dhe standardet ndërkombëtare për liri, barazi, demokraci, në interes të përparimit ekonomik, arsimor, kulturor e të gjithmbarshëm të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Betohemi! (Ministrat: Betohemi!)

(Duartrokitje në sallë.)

KRYETARI: Pas dhënies së betimit, i lus anëtarët e Qeverisë që ta nënshkruajnë deklaratën e betimit, pastaj do ta dorëzoni në Administratë.

Ndërkohë, kryeministri mund të mbajë një fjalë rasti.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar qytetarë,

Dëshiroj t'ju falënderoj për besimin e juaj. Dëshiroj po ashtu të theksoj përkushtimin që të punojmë me të gjithë bashkërisht, në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës, në interes të demokracisë, në interes të zhvillimit ekonomik dhe në interes të familjeve tona. Ju falënderoj për këtë besim të gjithë ju që votuat, falënderoj edhe ata që e dhanë votën kundër dhe ata që abstenuan, sepse është e drejtë e çdonjërit që të votojë.

Natyrisht, e gjithë kjo vlen për të gjithë ju, por jo për deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Atëherë, i falënderoj të gjithë deputetët e Republikës së Kosovës,
I falënderoj partnerët tanë ndërkombëtarë,
I falënderoj mediet,
Që sot e kemi të konstituuar edhe Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Mirupafshim në seancën e radhës! Faleminderit!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë